



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

**PROJEKT**

**STRATEGJIA PËR EDUKIMIN  
LIGJOR TË PUBLIKUT**

**2018-2023**

<b>Përmbajtja</b>	
<b>HYRJE</b> .....	6
<b>KAPITULLI I. KUADRI METODOLOGJIK I HARTIMIT TË STRATEGJISË SË EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT</b> .....	10
I.1 Procesi i hartimit të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut.....	10
I.2 Metodologjia për hartimin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut .....	11
<i>I.2.1 Gjithëpërfshirja</i> .....	11
<i>I.2.2 Transparenca dhe konsultimi publik</i> .....	12
<i>I.2.3 Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin politik e ligjor të brendshëm</i> 12	
<i>I.2.4 Hapat që do të ndërmerren për të siguruar zbatimin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut</i> .....	13
<b>KAPITULLI II: VËSHTRIM ANALITIK I SITUATËS AKTUALE TË EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT</b> .....	13
II.1 Parashikimet në aktet ndërkombëtare.....	13
II.2 Parashikimet në aktet strategjike dhe politike .....	15
<i>II.2.1 Edukimi Ligjor i Publikut në kuadër të reformës në drejtësi</i> .....	15
<i>II.2.2 Edukimi Ligjor i Publikut në kuadër të dokumenteve strategjike ekzistuese</i> .....	18
II.3 Parashikimet e legjislacionit të brendshëm .....	24
II.4 Kuadri institucional dhe përgjegjësitë e institucioneve në kuadër të ofrimit të Edukimit Ligjor të Publikut .....	31
II.5 Identifikimi i nevojave dhe fushave prioritare të Edukimit Ligjor të Publikut .....	42
II.5.1 Situata e deritanishme në lidhje me informimin dhe edukimin ligjor të publikut.....	43
<i>II.5.1.1 Gjetjet nga analiza e dokumenteve strategjike</i> .....	43
<i>II.5.1.2 Gjetjet nga analiza e kuadrit ligjor në fuqi</i> .....	44
<i>II.5.1.3 Gjetjet nga analiza e kuadrit institucional</i> .....	45
II.5.2 Fushat prioritare të edukimit ligjor të publikut.....	50
II.5.3 Edukimi ligjor i publikut në përputhje me nevojat e grupeve të veçanta të individëve .....	52
<b>KAPITULLI III. VIZIONI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE</b> .....	56
<b>KAPITULLI IV. OBJEKTIVAT DHE PRODUKTET MADHORE</b> .....	59
<b>KAPITULLI V. BURIMET FINANCIARE</b> .....	66
<b>KAPITULLI VI. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE</b> ....	66

VI.1 Institucionet zbatuese të SELP dhe të Planit të Veprimit .....	66
VI.2 Institucionet monitoruese të zbatimit të SELP dhe PV .....	69
VI.3 Raportimi periodik, metodologjia e raportimit dhe raportimet publike.....	70
VI.4 Analiza vlerësuese.....	71
VI.5 Treguesit e Monitorimit të SELP .....	71

DRAFT

## **Akronime**

AIDA - Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

AMSHC –Agjencia e Menaxhimit të Shoqërisë Civile

BE – Bashkimi Evropian

ELP – Edukimi ligjor i publikut

GENL- Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë

IZHA - Instituti për Zhvillimin e Arsimit

KLJG –Këshilli i Lartë Gjyqësor

Komisioni i Posaçëm- Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Kuvendi - Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

LGBT - përfshin të gjithë personat me orientim të ndryshëm seksual

MFP - Menaxhim i financave publike

MD- Ministria e Drejtësisë

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

NJQV- Njësi e Qeverisjes Vendore

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSHC – Organizatat e Shoqërisë Civile

OGP -Parimet e qeverisjes se hapur

OSBE – Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë

PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm

PV -Plan veprimi

RTSH – Radio Televizioni Shqiptar

Rrjet - Rrjeti Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut

SND - Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë

SELP - Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut

SKZHI - Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim

SPAK - Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

DRAFT

## HYRJE

Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) përcakton vizionin, qëllimet dhe objektivat strategjike të edukimit ligjor të publikut (ELP) përgjatë periudhës 2018-2023. SELP është dokumenti i parë strategjik i miratuar në Shqipëri me fokus të veçantë edukimin ligjor të qytetarëve. Ky dokument është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës hartimi dhe konsultimi.

Njohuritë mbi ligjin dhe edukimi ligjor i qytetarëve, luajnë një rol thelbësor në çdo shoqëri demokratike ku sjellja, veprimet dhe marrëdhëniet mes tyre disiplinohen nga norma e rregulla ligjore. Këto norma e rregulla janë ndonjëherë komplekse apo u nënshtrohen ndryshimeve të vazhdueshme. Mungesa e njohurive ose njohuritë e pamjaftueshme mbi ligjin dhe legjislationin në përgjithësi, passjell situatën ku qytetarët nuk kuptojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre. Për më tepër, e gjitha kjo rrënjës një kulturë të mosrespektimit dhe moszbatimit të ligjit në shoqëri, e cila përbën një kërcënim të qenësishëm për shtetin e së drejtës.

Aksesi i publikut në njohuritë mbi ligjin, është themelor për garantimin e një sistemi drejtësie efektiv. Kështu, informimi dhe dhënia e njohurive për ligjin, mbi të drejtat, institucionet ligjzbatuese, përgjegjësitë, etj, nuk janë të lidhura vetëm me arsimimin juridik, por janë përbërësit e kulturës dhe nevojës qytetare për qasjen ndaj shtetit të së drejtës<sup>1</sup>.

Gjithashtu, ELP-ja ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet e qytetarëve me organet e administratës publike. Duke patur dijeni mbi legjislationin, qytetarët kuptojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të administratës publike. Kështu, ata janë në gjendje t'ia referojë çështjen e tyre organit përkatës, duke formuluar saktë kërkesat dhe ankesat që adreson.

Përpos raportit të qytetarëve me institucionet e administratës publike, niveli i njohurive juridike luan rol kyç në sjelljen e vetë qytetarëve në sektorë të ndryshëm të jetës, si në marrëdhëniet e tyre familjare, të punës, ato juridiko-civile, ashtu dhe në veprimet e vendimet e tyre në mbrojtje të shëndetit, sigurisë, mjedisit, etj. Njohja e legjislationit që rregullon marrëdhëniet ku qytetarët janë të përfshirë, i nxit ata të respektojnë ligjin, i bën të shmangin veprimet e jashtëligjshme dhe të reduktojnë konfliktet.

Nëpërmjet përfutimit të njohurive ligjore, si dhe rritjes së sigurisë që qytetarët ndjejnë në përdorimin e ligjit, ELP kontribuon edhe në forcimin e qytetarisë aktive dhe në një kohezion më të madh shoqëror.<sup>2</sup> Qytetarët mund të organizohen e bashkëveprojnë për të mbikëqyrur veprimtarinë e organeve të pushtetit shtetëror dhe administratës publike, të ushtrojnë presion me mjete demokratike mbi këto organe, për të nxitur mbarëvajtjen e çështjeve me interes publik.

1 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Analiza e Sistemit të Drejtësisë, fq. 215  
[http://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti\\_shqip\\_0.pdf](http://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf)

2. Po aty

Kuadri aktual strategjik e ligjor përcakton një sërë detyrimesh në lidhje me masat që duhet të ndërmerren institucionet në kuadër të ELP-së. Megjithatë, problematikat e evidentuara në lidhje me të dëshmojnë se, zbatimi i këtyre detyrave, si dhe bashkërendimi i përpjekjeve për marrjen e masave për realizimin e tij ka qënë i fragmentuar dhe nuk ka dhënë rezultate të kënaqshme.

Reforma në sistemin e drejtësisë, e konceptuar mbi 7 shtylla bazë, që së bashku përbëjnë të plotë ndërtesën e sistemit të drejtësisë në vend, parashikon si një nga shtyllat e saj “Edukimi ligjor dhe arsimi juridik”. Këto 7 shtylla të reformës në sistemin e drejtësisë janë edhe pjesët kryesore përbërëse të Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri<sup>3</sup>, mbi gjetjet e të cilës është hartuar Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit<sup>4</sup> për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Këto dokumente, shërbyen si bazë për hartimin e ndryshimeve kushtetuese si dhe të paketës së projektligjeve që do të bëjë të mundur zbatimin e reformës në drejtësi, pjesë e të cilës është edhe Strategjia e Edukimit Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë.

Në Analizën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri evidentohen problematikat e lidhura me ELP-në duke vlerësuar se *“Institucionet shtetërore nuk kanë projekte e plane për të promovuar e mundësuar këtë formë edukimi. Nuk ka një strategji kombëtare për edukimin ligjor të Publikut. Nuk ka një koordinim dhe planifikim të mirë të edukimit vazhdues ligjor të publikut. Nuk ka një ndarje të detyrave institucionale dhe të shoqërisë civile, për edukimin dhe informimin vazhdues ligjor të publikut”*<sup>5</sup>.

Hartimi i SELP është mbështetur jo vetëm në gjetjet e Analizës së Sistemit të Drejtësisë, por edhe në objektivat e Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë, që pasoi këtë analizë, dhe ka përcaktuar si objektiv kryesor për ELP-në *rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për rëndësinë e zbatimit të ligjit*. Për realizimin e këtij objekti parashikohen të merren disa masa konkrete të cilat janë mbajtur në konsideratë dhe janë shtjelluar në këtë Strategji.

Gjithashtu, vënia në jetë e SELP-it përkon me fillimin e zbatimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të miratuara në kuadër të reformës në drejtësi. Kjo strategji synon të adresojë jo vetëm ELP-në në tërësi, por edhe dinamikat që paraqet Reforma në Drejtësi.

SELP bazohet në vlerësimin mbi gjendjen aktuale të ELP-së në Shqipëri dhe hartimi i saj është udhëhequr nga këto parime:

- a) *Respektim i ligjshmërisë në të gjitha fushat e jetës;*

3 Miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.14, dt.30.07.2015 “Për miratimin e Dokumentit ‘Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri; Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Analiza e Sistemit të Drejtësisë, fq. 215 [http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti\\_shqip\\_0.pdf](http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf)

4 Miratuar me vendimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, nr.15, datë 30.07.2015 “Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”. [https://reformanedrejttesi.al/sites/default/files/draft\\_strategjia\\_versioni\\_shqip.pdf](https://reformanedrejttesi.al/sites/default/files/draft_strategjia_versioni_shqip.pdf)

5 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Analiza e Sistemit të Drejtësisë, fq. 223 [http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti\\_shqip\\_0.pdf](http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf)

- b) *Qeverisje e hapur, që garanton transparencë dhe llogaridhënie në vendimmarrje, politikbërje dhe ligjbërje;*
- c) *Koordinim dhe bashkëveprim institucional në funksion të edukimit ligjor të publikut;*
- ç) *Akses i barabartë i individëve në edukimin ligjor;*
- d) *Profesionalizmi në ofrimin e edukimit ligjor;*
- dh) *Edukim ligjor i vazhdueshëm i shoqërisë duke ofruar njohuri dhe dije në përputhje me nevojat e gjithësecilit dhe komuniteteve në nevojë;*

SELP është organizuar në gjashtë kapituj kryesorë:

### **Kapitulli I: Kuadri metodologjik i hartimit të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut**

Në këtë kapitull trajtohet qasja metodologjike për hartimin e SELP e cila mbështetet dhe i referohet qasjes metodologjike të përcaktuar qartë në kuadër të procesit të reformës në drejtësi, pjesë e të cilës është edhe hartimi dhe miratimi i SELP.

### **Kapitulli II: Vështrim analitik i situatës aktuale të Edukimit Ligjor të Publikut**

Në këtë kapitull paraqitet kuadri aktual politik, ligjor dhe institucional i ELP. Kjo pjesë konstaton dhe analizon parashikimet lidhur me ELP në aktet ndërkombëtare, në aktet strategjike dhe në legjislacionin e brendshëm. Pas analizimit të parashikimeve të mësipërme, bëhet analiza e situatës së deritanishme në lidhje me ELP me qëllim identifikimin e fushave prioritare të ELP-së dhe të nevojave të grupeve të veçanta të individëve.

### **Kapitulli III. Vizioni dhe qëllimet strategjike**

Në këtë pjesë kapitull paraqiten:

- a) Vizioni, për realizimin dhe fuqizimin e ELP-së;
- b) Qëllimet strategjike nëpërmjet të cilave do të materializohet vizioni.

### **Kapitulli IV. Objektivat dhe produktet madhore**

Në këtë kapitull trajtohen objektivat specifike dhe produktet madhore që parashikohen lidhur me qëllimet strategjike për ELP-në për periudhën 2018-2023.

### **Kapitulli V. Burimet financiare**

Në këtë kapitull paraqitet mënyra se do të financohet zbatimi i SELP, nëpërmjet Planit të Veprimit (PV) të saj, duke përcaktuar edhe burimet e financimit.



## **Kapitulli VI. Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese**

Ky kapitull paraqet procedurat që zbatohen për garantimin e zbatimit të SELP duke përcaktuar institucionet zbatuese të SELP dhe PV, institucionet monitoruese të zbatimit të SELP dhe PV, raportimin periodik, metodologjinë e raportimit, analizën vlerësuese dhe treguesit e monitorimit të SELP.

Zbatimi i SELP do të realizohet **nëpërmjet hartimit të PV**, i cili do të jetë në përputhje me çfarë parashikohet në këtë Strategji dhe do të hartohet sipas parashikimeve në Kapitullin VI të kësaj Strategjie.

## KAPITULLI I. KUADRI METODOLOGJIK I HARTIMIT TË STRATEGJISË SË EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT

Metodologjia për hartimin e SELP mbështetet në qasjen metodologjike të përcaktuar qartë në kuadër të procesit të reformës në drejtësi, pjesë e të cilës është edhe hartimi dhe miratimi i SELP.

### *I.1 Procesi i hartimit të Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut*

Kuvendi, me Vendimin nr.96/2014<sup>6</sup> vendosi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Komisioni i Posaçëm ka patur, ndër të tjera, për objekt të veprimtarisë së tij edhe “*Hartimin e një dokumenti strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë*”. Për realizimin e detyrave të sipërpërmendura, pranë Komisionit të Posaçëm u ngrit Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i mbështetur nga një sekretariat teknik. Në përfundim të Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri dhe mbështetur mbi gjetjet e saj, u hartua nga GENL, me asistencën e sekretariatit teknik, Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Planin e Veprimit të saj. Në përfundim, me vendimin nr.14, dt.30.07.2015 “Për miratimin e Dokumentit ‘Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri’<sup>7</sup>, Komisioni i Posaçëm miratoi, Dokumentin “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri” dhe me vendimin nr.15, datë 30.07.2015 “Për miratimin në parim të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”<sup>8</sup>, Komisioni i Posaçëm miratoi në parim dokumentin Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë si dhe Planin e Veprimit për zhvillimin e kësaj strategjie. Këto dokumente shërbyen si bazë për hartimin e ndryshimeve kushtetuese si dhe paketës së projekt-ligjeve që do të bëjë të mundur zbatimin e reformës në drejtësi. Në Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë<sup>9</sup> parashikohet “*Edukimi ligjor dhe arsimi juridik*” si një nga 7 shtyllat bazë të reformës në sistemin e drejtësisë. Në datë 16 dhjetor 2016, u prezantua në Komisionin e Posaçëm paketa prej 27 projekt-ligjesh hartuar nga GENL së bashku me ekspertët ndërkombëtarë të EURALIUS, OPDAT dhe OSBE. Pjesë e paketës së akteve të reformës në drejtësi është edhe Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë.

Hartimi i SELP lindi si ide e nëngrupit të punës të ekspertëve të nivelit të lartë të reformës në drejtësi, përgjegjës për hartimin e projektligjeve lidhur me arsimin juridik. Gjatë diskutimeve të këtij nëngrupi pune u gjykua e nevojshme që arsimi juridik të trajtohej përtej konceptit formal dhe përveç institucioneve arsimore të përfshihen edhe organet shtetërore dhe shoqëria civile me qëllim zgjerimin dhe shtrirjen e edukimit ligjor ndaj shtresave të ndryshme të shoqërisë.

<sup>6</sup> [https://www.parlament.al/www-content/uploads/2015/10/vendim\\_nr\\_96\\_dt\\_27\\_11\\_2014\\_20207\\_1.pdf](https://www.parlament.al/www-content/uploads/2015/10/vendim_nr_96_dt_27_11_2014_20207_1.pdf)

<sup>7</sup> <http://reformatdrejtesise.al/vendim/vendim-nr14-dt-30072015>

<sup>8</sup> <http://reformatdrejtesise.al/vendim/vendim-nr15-dt-30072015>

<sup>9</sup> [http://www.euralius.eu/images/Justice-Reform/Strategjia-ne-Refomen-e-Sistemit-te-Drejtesise\\_24-07-2015.pdf](http://www.euralius.eu/images/Justice-Reform/Strategjia-ne-Refomen-e-Sistemit-te-Drejtesise_24-07-2015.pdf), fq.4.

Një kontribut të rëndësishëm në kuadër të hartimit të SELP kanë dhënë ekspertët e nivelit të lartë të këtij nëngrupi pune. Gjithashtu, gjatë procesit të hartimit të SELP, ekspertët e nivelit të lartë janë mbështetur nga stafi teknik i nëngrupit të punës si dhe nga grupi i punës i ngritur nga Koalicioni i shoqërisë civile “Drejtësi për të gjithë”<sup>10</sup>, të mbështetur nga organizata “Save the Children” me fondet e Bashkimit Europian dhe nga OSBE.

## ***1.2 Metodologjia për hartimin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut***

Metodologjia e përdorur mundëson që përmbajtja e dokumentit të jetë rezultat i një procesi gjithëpërfshirës, transparent, profesional, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin politik e ligjor të brendshëm.

### ***1.2.1 Gjithëpërfshirja***

Procesi i hartimit dhe i përmirësimit të vazhdueshëm të përmbajtjes së SELP është karakterizuar nga gjithëpërfshirja e institucioneve publike e të pavarura, akademikëve, ekspertëve, organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe partnerëve ndërkombëtare që kanë përgjegjësi/njohuri apo vepronë në fushën e ELP.

Gjithëpërfshirja e aktorëve të sipërpërmenduar konstatohet në të gjithë fazat e hartimit të SELP. Në GENL të ngritur pranë Komisionit të Posaçëm dhe përgjegjës për hartimin e SELP përfaqësoheshin institucionet më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë<sup>11</sup>. Gjithashtu, në funksion të një gjithëpërfshirje sa më të gjerë u krijua Rrjeti i Konsultimit Publik të Profesionistëve për reformën në drejtësi pranë Komisionit të Posaçëm, i përbërë nga rreth 1900 persona, përfaqësues të OSHC-ve, gjykatave dhe prokurorive të të tri niveleve, avokatë, profesorë të fakulteteve të drejtësisë, Shkollës së Magjistraturës dhe ekspertë të angazhuar në projekte kërkimore në fushën e drejtësisë.

<sup>10</sup> Anëtarët e grupit të punës përfaqësojnë OSHC-të anëtare të Koalicionit: Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (Qendra ALTRI); Instituti i Europës Juglindore për Kontratën Shoqërore (SSCI); Shërbimi Ligjor Falas (TLAS); Qendra Europiane; Komiteti Shqiptar i Helsinkit; Të ndryshëm dhe të barabartë dhe Qendra Psiko-Sociale Vatra.

<sup>11</sup> Përfaqësues të Gjykatës së Lartë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shkollës së Magjistraturës, Universitetit të Tiranës, Fakultetit të drejtësisë si dhe ekspertë ndërkombëtar përfaqësues të misionëve të asistencës ndërkombëtare për sistemin e drejtësisë në vendin tonë si : Euralius – BE, OPDAT-SHBA, Prezenca e OSBE-së, Komisioni i Venecias etj. Ftesës së Komisionit të Posaçëm për bashkëpunim në këtë proces ju përgjigjën pozitivisht edhe Presidenti i Republikës, Gjykata Kushtetuese, Ministria e Integritimit Evropian, Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Avokatura e Shtetit, Avokati i Popullit, Dhoma Kombëtare e Përmbauesve, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor etj, të cilët u përfaqësuan me ekspertë në Sekretariatit Teknik.

Duke marrë në konsideratë objektin e SELP, nëngrupi i punës bashkëpunoi ngushtë me OSHC-të me eksperiencë në fushën e ELP.

### ***1.2.2 Transparenca dhe konsultimi publik***

Projekti i parë i SELP iu nënshtrua një procesi konsultimi transparent dhe gjithëpërfshirës. Procesi i konsultimit përfshiu një gamë të gjerë aktorësh si institucione publike e të pavarura, akademikë, ekspertë, OSHC dhe partnerë ndërkombëtarë të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ELP. Ky proces u zhvillua nëpërmjet takimeve konsultuese apo kërkesës për të paraqitur kontribut me shkrim.

Sugjerimet e dërguara u reflektuan në projektin e dytë të kësaj Strategjie. Një kontribut të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të projektit të dytë të SELP ka dhënë grupi i punës i ngritur nga Koalicioni i shoqërisë civile “Drejtësi për të gjithë” dhe Departamenti i Zhvillimeve dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri.

Projekti i dytë i SELP iu nënshtrua një procesi tjetër konsultimi publik nëpërmjet shpërndarjes për mendim të këtij projekti në institucione publike e të pavarura, akademikë, ekspertë, OSHC dhe partnerë ndërkombëtarë, si dhe organizimit të takimeve konsultuese në 4 rajone të vendit (Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë) me qëllim diskutimin e këtij dokumenti strategjik me institucionet publike, bashkitë dhe OSHC-të në nivel lokal.

Sugjerimet e dërguara dhe mbledhura nga procesi i dytë i konsultimit publik u reflektuan në projektin përfundimtar të kësaj Strategjie.

### ***1.2.3 Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare dhe kuadrin politik e ligjor të brendshëm***

Procesi i hartimit të SELP ka fillur menjëherë pas miratimit të Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë. Për përcaktimin e përmbajtjes dhe të politikave të kësaj Strategjie ekspertët janë mbështetur fillimisht në problematikat dhe gjetjet e evidentuara në Analizën e Sistemit të Drejtësisë dhe në orientimet e Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë. Më pas, për të zhvilluar një analizë më të thelluar të situatës aktuale të ELP në Shqipëri, ekspertët mblodhën të dhëna nga institucionet dhe aktorë të ndryshëm të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në ELP,<sup>12</sup> si dhe zhvilluan punë kërkimore në drejtim të identifikimit të kuadrit ndërkombëtar, ligjor e politik që trajton ELP<sup>13</sup>. Mbështetur në analizën e situatës aktuale të ELP, ekspertët përcaktuan vizionin, qëllimet dhe objektivat strategjike të ELP për 5 vitet e ardhshme.

---

<sup>12</sup> U kërkuan të dhëna nga 11 ministri, 16 institucione publike e të pavarura, 61 bashki, 11 organizata ndërkombëtare, 33 ambasada dhe rreth 500 OSHC. Nga të gjithë institucionet e konsultuara kthyen përgjigje 72% e ministrive; 30% e bashkive dhe 50% e institucioneve të tjera.

### ***I.2.4 Hapat që do të ndërmerren për të siguruar zbatimin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut***

Pas miratimit të SELP, do të ndërmerren disa hapa me qëllim që të sigurohet zbatimi sa më i mirë i saj. Ndër hapat që do të ndërmerren mund të përmendim në mënyrë jo shteruese:

- ✓ hartimin e PV të SELP nën mbikqyrjen dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, brenda 6 muajve nga data e miratimit të SELP.
- ✓ ngritjen e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut pranë Kuvendit, brenda vitit 2018.
- ✓ trajnimin e punonjësve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e SELP dhe PV, brenda vitit 2018.
- ✓ zhvillimin e një fushate informimi e edukimi të publikut lidhur me parashikimet e SELP dhe mbi iniciativat/aktivitetet e PV në dobi të qytetarëve, gjatë vitit 2018-2019.

## **KAPITULLI II: VËSHTRIM ANALITIK I SITUATËS AKTUALE TË EDUKIMIT LIGJOR TË PUBLIKUT**

### ***II.1 Parashikimet në aktet ndërkombëtare***

E drejta për edukim është një e drejtë themelore e njeriut, e cila garantohet në terma të përgjithshëm nga një sërë aktesh ndërkombëtare. Ndër këto akte vlen të përmendim Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Konventën e UNESCO-s Kundër Diskriminimit në Edukim<sup>14</sup>, Konventën e OKB-së kundër Eleminimit të të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor<sup>15</sup>, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike<sup>16</sup>, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore<sup>17</sup>, Konventën e OKB-së për Eleminimin e të Gjitha

14 Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 21.11.1963.

15 Aderuar nga Republika e Shqipërisë më 1994.

16 Aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7510/1991 “Për aderimin në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike”.

17 Aderuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7511/1991 “Për aderimin në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”

Formave të Diskriminimit ndaj Grave<sup>18</sup>, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës<sup>19</sup>, Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>20</sup>, Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje<sup>21</sup> dhe Deklarata e OKB-së mbi Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit.

Ndërkohë, në nivel rajonal e drejta për edukim garantohet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe konkretisht nga neni 2 i Protokollit 1 të Konventës<sup>22</sup> dhe Vendimi Kuadër i BE-së mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal.

Pavarësisht garancive dhe parashikimeve të së drejtës ndërkombëtare në lidhje me të drejtën e qytetarëve për edukim, në përgjithësi është ndjerë nevoja për ELP-në, nevojë kjo e shprehur fillimisht në vitin 1993 në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut organizuar nga OKB-ja ku të gjitha shteteve palë iu bë thirrje për të përfshirë konceptet e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës në të gjitha kurrikulat formale dhe jo formale të edukimit. E drejta për edukim është pjesë e rëndësishme e angazhimeve të marra nga shtetet anëtare të OSBE-së, ashtu si edhe nga Republika e Shqipërisë<sup>23</sup>. Gjithashtu, në kuadër të nevojës në rritje që qytetarët të njihen dhe zotërojnë konceptet ligjore bazë, Këshilli i Evropës miratoi në vitin 2010 Kartën për Edukimin e mbi Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut<sup>24</sup>.

Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, kërkon nga shtetet palë të garantojnë nivel të lartë shpërndarjeje për publikun e gjerë, të informacionit mbi masat e vëna në dispozicion për parandalimin e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente. Neni 19 i Konventës, “Informimi” kërkon që palët të marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të marrin informacion të mjaftueshëm dhe në kohë, në një gjuhë që kuptojnë, në lidhje me shërbimet e disponueshme mbështetëse dhe masat ligjore.

Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO), në raportin fillestar të vlerësimit për Shqipërinë, në lidhje me masat legjislative dhe të tjera të ndërmarra në zbatim të dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër

18 Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7767/1993 “Për aderimin në Konventën e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”.

19 Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7531/1991 “Për ratifikimin e Konvetës së OKB-së për të drejtat e fëmijës”.

20 Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

21 Ligji Nr. 104/2012, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”

22 Neni 2 i Protokollit 1 KEDNJ “*Askujt nuk mund t`i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.*”

23 Angazhimet e OSBE-së në Dimensionin Njerëzor, faqe 148, <http://www.osce.org/odihr/76894?download=true>

24 Miratuar në kuadër të Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM/Rec (2010)7.

Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje<sup>25</sup> (24 Dhjetor 2017) për të fuqizuar gratë viktime, fton autoritetet:

a. të sigurojnë që gratë viktime të marrin informacionin e duhur dhe në kohë, duke i ndihmuar ato të marrin vendime të informuara dhe të ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtat e tyre për mbështetje dhe mbrojtje;

b. të hartojnë informacion të përshtatshëm e kuptimplotë për grupet e grave vulnerabël, përfshirë informacion në gjuhët e pakicave minoritare, si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë që synon angazhimin e grupeve “të vështira për t'u arritur” dhe aksesin e tyre në shërbime (paragrafi 90).

Shqipëria, në respektim të neneve 121 dhe 122, të Kushtetutës ka ratifikuar dhe bërë pjesë të legjislacionit të saj të brendshëm aktet ndërkombëtare të sipërpërmendura. Në zbatim të së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme, garancitë dhe detyrat që iu lihen institucioneve shtetërore nga këto marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara duhet të zbatohen me rigorozitet.

Përpos këtyre konventave, në kuadër të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Europian nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA)<sup>26</sup> detyron vendin tonë, respektivisht në kuadër të nenit 100 të MSA-së, të rrisë nivelin e përgjithshëm të edukimit të qytetarëve, si dhe të garantojë aksesin në edukim për të gjithë individët pa diskriminim në racë, gjini, besim ose përkatësi fetare. Gjithashtu, në paragrafin e fundit të këtij neni parashikohet se palët duhet të kenë në konsideratë të posaçme njohjen e publikut me *acquis* e BE-së. Në Raportin e Progresit të vitit 2016 Komisioni Evropian ka konstatuar se Shqipëria duhet të bëjë më tepër përpjekje në miratimin dhe zbatimin e këtij kuadri normativ, veçanërisht në zbatim të reformës në drejtësi.<sup>27</sup> Të gjitha këto parashikime kanë si qëllim final kontribuimin në konsolidimin e shtetit të së drejtës.<sup>28</sup>

## II.2 Parashikimet në aktet strategjike dhe politike

### II.2.1 Edukimi Ligjor i Publikut në kuadër të reformës në drejtësi

Në kuadër të vlerësimit të situatës aktuale të ELP, Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri<sup>29</sup> evidenton disa gjetje të rëndësishme si më poshtë:

1. Institucionet shtetërore nuk kanë projekte e plane për të promovuar e mundësuar këtë formë edukimi.
2. Nuk ka një strategji kombëtare për edukimin ligjor të Publikut.

<sup>25</sup> Konkluzionet dhe rekomandimet e mëposhtme janë marrë nga raporti i plote i GREVIOs për Shqipërinë, <https://rm.coe.int/grevio-first-baseline-report-on-albania/16807688a7>

<sup>26</sup> Ratifikuar me ligjin nr.9590, dt.27.7.2006 ”Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”

<sup>27</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf) fq. 4.

<sup>28</sup> Neni 100 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit

<sup>29</sup> Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Analiza e Sistemit të Drejtësisë, fq. 223 dhe 226 [http://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti\\_shqip\\_0.pdf](http://www.reformanedrejtisi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip_0.pdf)

3. Nuk ka një koordinim dhe planifikim të mirë të edukimit vazhdues ligjor të publikut.
4. Nuk ka një ndarje të detyrave institucionale dhe të shoqërisë civile, për edukimin dhe informimin vazhdues ligjor të publikut.
5. Nuk konstatohet ndonjë institucionalizim i edukimit ligjor për shtetasit. Nuk ka ndonjë institucion koordinues ose përgjegjës që të nxisë, të organizojë dhe monitorojë këtë veprimtari të rëndësishme.
6. Deri tani edukimi ligjor është kryer me anë të projekteve dhe iniciativave të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë.

Njëkohësisht me evidentimin e problematikave lidhur me ELP, Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri identifikon edhe objektivat e qëllimet që duhet të përmbushë ELP në të ardhmen të cilat, në mënyrë jo shteruese, përfshijnë<sup>30</sup>:

1. Kombinimin e dhënies së informacionit të nevojshëm dhe zhvillimin e njohurive, rritjen e kapacitetit për të kuptuar dhe aftësive të nevojshme për të marrë vendimet e duhura në situata që lidhen me të drejtat dhe detyrimet ligjore;
2. Dhënien e mundësisë për qytetarët që të orientohen brenda spektrit të gjerë ligjor, duke njohur të drejtat dhe detyrimet e tyre, dhe për rrjedhojë në disa raste dhe duke i aftësuar në identifikimin paraprak dhe shmangien e problemeve të mundshme në të ardhmen ose përshkallëzimin e tyre;
3. Më shumë pjesëmarrje, vend dhe rol për profesionistët e së drejtës;
4. Mbështetjen e qytetarit për të (i) njohur të drejtat; (ii) kuptuar rolin dhe funksionet e institucioneve dhe mekanizmave të dhënies së drejtësisë; (iii) kuptuar konceptin e qytetarisë në shtetin e së drejtës; (iv) përditësimin e dijeve mbi legjislacionin e fushës së interesit.

Ndërsa format e realizimit të ELP-së duhet të përfshijnë<sup>31</sup>:

1. Informim dhe ndërgjegjësim të vazhdueshëm, masiv për çështje me natyrë dhe interes të përgjithshëm dhe problematik për një aspekt të caktuar. Fushatat mediatike kanë qëllim të informojnë dhe sensibilizojnë në mënyrë të shpejtë dhe të shkurtër për një fenomen specifik, ndërkohë që burime më të qëndrueshme si një faqe interneti apo një linjë telefonike synojnë një përkrahje të vazhdueshme për një informacion më të hollësishëm mbi fusha të caktuara. Secila qasje sigurisht ka një avantazh të saj, por zgjedhja e secilës është gjithmonë në varësi të qëllimit që dëshirohet të realizohet nëpërmjet edukimit ligjor në një rast specifik;
2. Përgatitje, publikim dhe shpërndarje e materialeve informuese për një problem specifik si p.sh. dhuna në familje, të drejtat e konsumatorit; artikuj në gazeta etj;
3. Historitë e suksesit ose jo, përmes të cilave reflektohet qëndrimi i drejtë ose i gabuar;
4. Njohjen me institucionet specifike, shërbimet dhe rolin e tyre kundrejt mbrojtjes së qytetarit ose aksesit në drejtësi të tilla si ndërmjetësimi, noteria, ndihma ligjore, etj;

30. Po aty, fq 215;

31. Po aty fq. 215;



5. Një faqe interneti e cila të jetë e specializuar në disa fusha specifike të së drejtës ndaj të cilave qytetarët janë më të ekspozuar në veprimtaritë e tyre të përditshme. Ky edukim ligjor në këtë aspekt, është i një natyre të përhershme dhe ka më tepër qëllim konsultativ dhe udhëzues për ushtrimin e të drejtave të qytetarëve se sa rol parandalues për mosshkeljen e tyre;
6. Ditët e hapura në institucione të ndryshme shtetërore dhe oraret publike të unifikuara;
7. Takime me profesionistë të ndryshëm të drejtës.

Në tërësi ELP-ja mund të organizohet dhe ofrohet nga burime dhe forma të ndryshme. Ajo mund t'u drejtohet qytetarëve në përgjithësi, politikëbërësve apo segmenteve të caktuara shoqërore me një nevojë të veçantë.

Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë që pasoi Analizën e Sistemit të Drejtësisë ka përcaktuar si objektiv kryesor për ELP-në *rritjen e ndërgjegjësimit qytetar për rëndësinë e zbatimit të ligjit*. Për realizimin e këtij objektivit parashikohen të merren disa masa konkrete të cilat janë<sup>32</sup>:

1. Përfshirjen e edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar dhe pasurimin e kurrikulave dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare të sistemit arsimor parauniversitar me elementë të edukimit ligjor në fushën e së drejtës penale, administrative, fiskale, civile dhe familjare, si edhe rishikimin e natyrës së informacionit që u ofrohet nxënësve duke e vënë theksin tek natyra juridike dhe jo vetëm moralizuese, e të drejtave dhe detyrimeve të fëmijëve dhe të rinjve;
2. Përgatitjen e stafit pedagogjik me nivelin e domosdoshëm të njohurive juridike përmes përfshirjes së lëndëve të detyrueshme të edukimit ligjor në kurrikulat universitare të programeve të mësuesisë, si edhe përmes programeve të trajnimit vazhdues;
3. Rritjen e njohurive praktike mbi funksionimin e institucioneve vendimmarrëse, atyre ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe nxitjen e aktivizimit të publikut dhe rritjen e kohezionit social përmes informimit mbi mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje;
4. Pasurimin e njohurive juridike të publikut përmes ngritjes së portaleve informative të natyrës praktike në fushën e së drejtës penale, civile, fiskale, administrative dhe familjare;
5. Njohjen me alternativat e zgjidhjes së konflikteve, larg vetëgjyqësisë dhe hakmarrjes, me qëllim parandalimin e kriminalitetit dhe të sjelljeve të kundërligjshme, sensibilizimin mbi avantazhet e zgjidhjes me ndërmjetësim dhe arbitrim të mosmarrëveshjeve përmes organizimit të fushatave masive edukative për publikun;
6. Rritjen e aksesit në drejtësi përmes ofrimit të informacioneve të thjeshta dhe programeve të posaçme informative për publikun mbi sistemin e drejtësisë;
7. Detyrimin ligjor të institucioneve shtetërore për mbështetjen e projekteve për botimin e librave të përdorimit qytetar “Ligji në jetën tuaj”, si domosdoshmëri për njohjen nga qytetarët të normave bazë të legjislacionit evropian dhe shqiptar, kryesisht të normave e rregullave që

32 Strategjia e reformes ne sistemin e drejtësi, fq. 29, <http://www.reformanedrejttesi.al/dokumenti-strategjik-dhe-plani-i-veprimit>

lidhen me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, njohjen e detyrimeve dhe procedurave fiskale, të drejtat e konsumatorëve, të drejtën e informimit të publikut, detyrimin e institucioneve për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve etj.

Strategjia e reformës në sistemin e drejtësisë u shoqërua nga PV-ja, ku në pjesën e IV parashikohen masat që duhet të ndërmerreshin gjatë vitit 2015-2016 për përbushjen e objektivave të sipërpërmendur<sup>33</sup>. Një pjesë e mirë e masave të parashikuara rezultojnë ende të pazbatuara.

### **II.2.2 Edukimi Ligjor i Publikut në kuadër të dokumenteve strategjike ekzistuese**

Vitet e fundit janë miratuar një numër i konsiderueshëm strategjish, si dhe dokumentesh të tjerë të rëndësishëm që orientojnë politikën e zhvillimit në bazë të sektorëve të ndryshëm. Disa prej tyre parashikojnë në mënyrë thelbësore përfshirjen e qytetarit, si dhe metodologji apo strategji komunikimi me apo për publikun. Konkretisht, disa prej këtyre strategjive janë si më poshtë:

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim e Integrim (SKZHI) 2015-2020<sup>34</sup>** ka në themel të vizionit të saj *“konsolidimin e qeverisjes së mirë, demokracisë dhe shtetit ligjor, konsolidimi dhe forcimi i të cilave do të realizohen nëpërmjet disa objektivave të përcaktuara. Në shtyllën 3 të SKZHI-së përcaktohen drejtimet kryesore të investimit në kapitalin njerëzor e kohezionin social<sup>35</sup>: *burimi më i rëndësishëm i Shqipërisë janë njerëzit, populli i saj, dhe bashkë me të, shoqëria dhe kultura e saj.* Pikërisht në segmentet e kësaj shoqërie janë të mishëruara edhe vlerat thelbësore të lirisë, barazisë, mirëqenies dhe sigurisë së personit dhe të pronës. Në SKZHI theksohet objektivi i qeverisë për ofrimin e shërbimeve publike novative me në qendër qytetarin, ku si shtylla kryesore përmenden (1) ngritja dhe menaxhimi i një modeli mbarëkombëtar të integruar të ofrimit të shërbimeve, ku sportelet pritëse të shërbimit do të përqëndrohen tek marrëdhëniet me publikun dhe do të jenë të ndara nga Zyra Trajtuese e Shërbimit nëpërmjet ngritjes së qendrave me një ndalesë; (2) standardizimi i ofrimit të shërbimeve nga administrata (Zyra Pritëse dhe Trajtuese), njëkohësisht dhe thjeshtësimi i proceseve të reja të punës, për të garantuar që këto procese të jenë të mirëpërcaktuara dhe të qarta, si dhe për të mos lënë hapësirë për praktika korruptive; (3) dixhitalizimi i regjistrave dhe arkivave shtetërore dhe përqëndrimi e zhvillimi i shërbimeve on-line; dhe (4) **zgjerimi i kanaleve të informacionit për qytetarët dhe monitorimi i performancës për ofrimin e shërbimeve, me synim përmirësimin e vazhdueshëm<sup>36</sup>.***

Po këtu, në kuadër të objektivit strategjik për rritjen e transparencës dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë synohet përmirësimi i mundësive të publikut për t'u njohur me

33 [https://reformatdrejtesi.al/sites/default/files/draft\\_strategjia\\_versioni\\_shqip.pdf](https://reformatdrejtesi.al/sites/default/files/draft_strategjia_versioni_shqip.pdf)

34 Miratuar me VKM nr. 348 datë 11.05.2016, publikuar në fletoren zyrtare nr. 86, faqe 4795 e disponueshme online në adresën: <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Vendim%20i%20KM:348:11.05.2015>

35 SKZHI faqe 33

36 SKZHI faqe 46

normat dhe informacionin ligjor, duke rritur botimet e gazetave zyrtare, kodeve dhe përmbledhjeve të legjislaconit, etj<sup>37</sup>.

**Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017-2021**, përcakton si një ndër objektivat strategjike të saj edhe *konsolidimin e aksesit në organet e drejtësisë për të qenë i hapur për çdo person dhe për të qenë aktivisht i angazhuar në inkurajimin e formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve*. Ky qëllim do të realizohet nëpërmjet rritjes së aksesit të publikut për njohjen e legjislacionit, efektivitetit të ndihmës juridike, përmirësimit të marrëdhënies me publikun, efektivitetit të formave alternative dhe përmirësimit dhe forcimit të rolit të aktorëve ndihmës të sistemit të drejtësisë dhe profesioneve të lira.

**Agjenda kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2017-2020**<sup>38</sup>, ka vlerësuar si një domosdoshmëri edukimin ligjor të fëmijëve që në fazat e para të jetës, ndër të tjera duke përmirësuar kurrikulat për arsimimin të tyre<sup>39</sup>. Kjo Agjendë ka parashikuar një shtyllë strategjike ku parashikohen sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijët dhe adoleshentët, ku si objektiv specifik parashikohet përmirësimi i aksesit të fëmijëve në drejtësi. Për realizimin e këtij objektiivi janë parashikuar aktivitete konkrete dhe të matshme për edukimin ligjor të fëmijëve dhe familjeve të tyre<sup>40</sup>.

Vlen të përmendet edhe **Rezoluta e Kuvendit, datë 7.5.2015, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBT**<sup>41</sup> e pasuar me **Miratimin e Planit të Veprimit për Personat LGBTI**<sup>42</sup> e cila ka parashikuar një sërë objektivash për mobilizimin e aktorëve kryesorë për edukimin ligjor të personave LGBTI si dhe rritjen e ndërgjegjësisimit për të drejtat e tyre.

**Në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020**<sup>43</sup> parashikohet si një ndër politikat kryesore nxitja e kulturës së sipërmarrjes dhe edukimit për sipërmarrjen. Sipas kësaj strategjie mësimi për sipërmarrjen është një nga kompetencat kyçe në nivel evropian dhe duhet të përfshihet në të gjitha nivelet e edukimit që nga niveli primar, sekondar, i mesëm dhe i lartë. Procesi përfshin jo vetëm reformën në kurrikula në të gjitha nivelet, por edhe një numër programesh për nxitjen e kulturës së sipërmarrjes nëpërmjet trajnimeve. Kjo do të realizohet nëpërmjet: i) zhvillimit të programeve për futjen e sipërmarrjes në programet bazë të edukimit në të gjitha nivelet; ii) hartimit të kurrikulës për sipërmarrjen dhe programeve trajnuese për zhvillimin e aftësisë sipërmarrëse në kurset disa mujore profesionale; iii) zhvillimit të programeve trajnuese për të rinjtë dhe femra që

<sup>37</sup> SKZHI faqe 63

<sup>38</sup> Miratuar me VKM nr. nr 372, datë 26.04.2017 e disponueshme online ne: <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2017/06/Agjenda-kombetare-per-te-drejtat-e-femijeve.pdf>

<sup>39</sup> Agjenda faqe 15

<sup>40</sup> Agjenda faqe 82, 83

<sup>41</sup> E disponueshme online ne: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/77-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/77-2015.pdf)

<sup>42</sup> Miratuar me nr. 390, datë 25.5.2016 e disponueshme online ne: [http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Baza\\_Ligjore/Mbrojtja\\_sociale/Plani\\_Kombetar\\_per\\_LGBTI.pdf](http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Baza_Ligjore/Mbrojtja_sociale/Plani_Kombetar_per_LGBTI.pdf)

<sup>43</sup> Miratuar me VKM, Nr.635, Dt. 01.10.2014, Flet.Zyrtare Nr.157, Faqe 8045

kërkojnë të fillojnë një biznes, të diplomuarit, të papunët, rikualifikimin dhe informacione të vazhdueshme; iv) analizës periodike të nevojave për trajnime; v) hartimit të programeve të trajnimeve dhe moduleve përkatëse për sipërmarrjen; vi) trajnimeve online. Shtetet që aspirojnë për të hyrë në BE duhet të konsiderojnë projektet e promovimit e sipërmarrjes jashtë aktiviteteve shkollore si pjesë e edukimit të të rinjve. Media gjithashtu duhet të luajë rol në promovimin e kulturës sipërmarrëse.

Në **Strategjinë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2014 – 2020**<sup>44</sup>, konstatohet se edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe tregtarëve është pa dyshim një nga elementët që kontribuojnë në sigurimin e një klime më miqësore ndaj konsumatorëve, si dhe rritjen e transparencës së praktikave tregtare. Për këtë qëllim, me synim njohjen e kuadrit ligjor të mbrojtjes së konsumatorëve dhe të sigurisë së produkteve, është zhvilluar një fushatë ndërgjegjësuëse për konsumatorët dhe operatorët ekonomikë, duke iu drejtuar konsumatorëve, nxënësve, operatorëve ekonomikë, mediave etj<sup>45</sup>. Në thelb të qëllimit dhe politikave të kësaj strategjie vlerësohet të arrihet **përmirësimi i edukimit të konsumatorëve për pjesëmarrje aktive në treg dhe përmirësimi i informimit dhe ndërgjegjësimi të konsumatorëve dhe operatorëve ekonomikë për të drejtat e konsumatorëve**. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve konsiderohet një proces dhe kërkon një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Përveç ditëve të informimit, stendave informuese, botimeve apo fletëpalosjeve, do t'i vihet përparësi edukimit të konsumatorëve që mund të fillojë që në moshat e vogla, edhe me elementë dhe gjuhë të thjeshtë. Gjithashtu, kjo do të ndiqet edhe me vazhdimin e fuqizimit të institucioneve zbatuese, të cilat janë përcjellësi më i mirë i mesazheve pozitive të konsumatorët për zbatueshmërinë e ligjit<sup>46</sup>.

**Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020**<sup>47</sup> ka parashikuar se do të merren masa për të përmirësuar më tej aksesueshmërinë dhe transparencën, dhe se qeveria do të vërë në dispozicion të dhëna mbi financat dhe operacionet e saj nëpërmjet një “portali transparence” të hapur për publikun. Nëpërmjet portalit do të vihet në dispozicion të publikut një grup raportesh të shkarkueshëm të paracaktuara për financat publike, të përshtatura ndaj nevojave të kategorive të ndryshme të përdoruesve: organeve politike, medias, publikut të përgjithshëm dhe partnerëve ndërkombëtarë të Shqipërisë. Në një hap të dytë, do të ketë një element funksional për kërkime më fleksibël dhe kërkime më të thelluara në të dhënat financiare dhe materiale të ruajtura në një bazë për ruajtjen e të dhënave për akses të shpejtë dhe fleksibël<sup>48</sup>. Një prej tre qëllimeve strategjike të kësaj strategjie është të bëjë më transparente për Parlamentin, sektorin financiar, komunitetin e

44 Miratuar me VKM, Nr.753, Dt. 16.09.2015, e disponueshme online në: <http://kmk.ekonomia.gov.al/ep-content/uploads/2015/11/Strategjia-e-Mbrojtjes-se-Konsumatorëve-dhe-Mbikëqyrjes-se-Tregut.pdf>

45 Strategjia fq. 31

46 Strategjia fq. 36

47 Miratuar me VKM, nr. 908, Dt. 17.12.2014, botuar në fletoren zyrtare nr.204, fq.1223 e disponueshme online në: [http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Raportimet/Strategjia\\_per\\_Menaxhimin\\_e\\_Financave\\_Publike\\_2014-2020.pdf](http://www.financa.gov.al/files/userfiles/Raportimet/Strategjia_per_Menaxhimin_e_Financave_Publike_2014-2020.pdf)

48 Strategjia fq. 57

biznesit, partnerët ndërkombëtarë dhe publikun e gjerë, politikat e ndjekura dhe përpjekjet e bëra nga Qeveria për forcimin e MFP-së në vend<sup>49</sup>.

Edhe në **Strategjinë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020**<sup>50</sup> parashikohet si mjaft i rëndësishëm informimi e edukimi i publikut përgjatë kohës së implementimit të politikave. Specialistët e mbrojtjes së bimëve janë përgjegjës për këshillimin, informimin dhe edukimin e fermerëve mbi çështjet e mbrojtjes së bimëve. Po ashtu në strategji thuhet se prioritet është investimi në trajtimin e mbetjeve dhe edukimin e fermerëve, si dhe zbatimin e legjislacionit<sup>51</sup>.

Në **Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2016-2020**<sup>52</sup> parashikohet gjerësisht përgjatë objektivave strategjike përfshirja dhe ndërgjegjësimi i popullatës lidhur me çështjet e shëndetit, pjesëmarrjes në vendimmarrje etj.

Në **Strategjinë Sektoriale të Rendit Publik 2014-2020**<sup>53</sup> konsiderohet e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të filozofisë dhe të praktikës së policimit në komunitet, konsolidimi i partneritetit me komunitetin, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve administrative që ofrohen për qytetarin dhe biznesin. Sipas kësaj strategjie, forcimi i besimit dhe i mbështetjes së opinionit publik kërkon vëmendje, për:

1. ofrimin e shërbimeve të policimit, pranë qytetarëve;
2. zhvillimin e kapaciteteve për marrëdhëniet me publikun;
3. zhvillimin më tej të bashkëpunimit me shoqërinë civile;
4. promovimin e projekteve dhe iniciativave me autoritetet lokale, shkollat, organizatat jofitimprurëse;
5. promovimin e lidhjes telefonike apo aplikimeve “pa pagesë”, që qytetarët të informojnë për shkeljet ligjore, si dhe të raportojnë për sjelljet dhe shërbimet e Policisë;
6. zgjidhjen e ankesave dhe shkëmbimin e informacionit;
7. respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti personave të shoqëruar, ndaluar e arrestuar në ambientet e Policisë;
8. zhvillimin e iniciativave të parandalimit të krimit etj.;
9. shtimin e komunikimit e transparencës me opinionin publik etj.

Edhe **Strategjia Ndërsektoriale për Administratën Publike 2015-2020**<sup>54</sup> ka përcaktuar në qëllimet e politikave çështje të informimit të ELP-së. Institucionet nuk e kanë ende të mishëruar në

---

49 Strategjia fq. 15

50 Miratuar me VKM-në nr. 709, datë 29.10.2014, Fletore Zyrtare 169/2014, e disponueshme online në: [http://www.akti.gov.al/dokumenta/VKM\\_709\\_%2029\\_10\\_2014.pdf](http://www.akti.gov.al/dokumenta/VKM_709_%2029_10_2014.pdf)

51 Strategjia fq. 8518, 8505, 8507 e Fletores Zyrtare.

52 Miratuar me VKM, Nr.439, Dt. 17.05.2017, Fletore Zyrtare nr. 119.

53 Miratuar me VKM, Nr.702, Dt. 26.08.2015, Fletore zyrtare nr. 155 faqe 11141 e disponueshme online në: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/155-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/155-2015.pdf)

54 Miratuar me VKM, Nr.319, Dt. 15.04.2015, Fletore Zyrtare nr. 62 faqe 2737 e disponueshme online në:

aktivitetin e tyre të përditshëm qëllimin për thjeshtimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe krijimin e një qasjeje miqësore për publikun. Ky dokument përcakton se është e nevojshme të ndërmerret një iniciativë për rishikimin e proceseve të punës të lidhura me ofrimin e shërbimeve dhe ndryshimin e kuadrit ligjor përkatës. Në këtë strategji janë të parashikuara objektiva dhe aktivitetet konkrete që lidhen me garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion. Në këtë kuadër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ka kontribuar me realizimin e aktiviteve si vënia në zbatim e programit institucional të transparencës nga autoritetet publike ku me miratimin e ligjit për të drejtën e informimit, të gjitha institucionet duhet të përgatisin dhe të zbatojnë programin institucional të transparencës, me qëllim garantimin e aksesit në informacion nga qytetarët dhe shoqëria civile.

**Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020<sup>55</sup>** gjithashtu në një prej qëllimeve strategjike “*Qeverisja e hapur, transparenca, llogaridhënia, e- qeverisja në nivelin vendor*”, përcakton se qeverisja vendore do të kthehet nga një qeverisje e mbyllur dhe jo transparente në një qeverisje të hapur me orientim nga qytetarët. Shqipëria është bërë pjesë e vendeve që janë angazhuar të zbatojnë parimet e qeverisjes së hapur (OGP). Parimet e qeverisjes së hapur, transparencës dhe llogaridhënies do të jenë parime të detyruara për t’u aplikuar nga njësitë e qeverisjes vendore me ndryshimet që do i bëhen ligjit të ri organik të qeverisjes vendore dhe akteve nënligjore. Të gjitha vendimet në nivel vendor do të synohen të merren me pjesëmarrjen e qytetarëve në mënyrë të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe transparente. Njësitë e qeverisjes vendore do të marrin të gjitha masat dhe strategjitë për promovimin dhe sigurimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrje.

**Strategjia Ndërsektoriale për Antikorrupsionin 2015-2020<sup>56</sup>**, në mënyrë të qartë parashikon si objektiv më vete qasjen ndërgjegjësuese ku përfshin “*ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut të gjërë mbi pasojat e korrupsionit*”. Bashkëpunimi i publikut në luftën kundër korrupsionit është një domosdoshmëri. Për të siguruar këtë bashkëpunim, institucionet përgjegjëse duhet të bëjnë të mundur sensibilizimin e publikut për pasojat negative të korrupsionit mbi jetën e çdo anëtari individual të shoqërisë. Si mjete ndërgjegjësimi për korrupsionin janë përfshirë në kurrikulat shkollorë të edukimit në vazhdim; realizimi i fushatave kombëtare kundër korrupsionit; realizimi i fushatës lidhur me denoncimin nga sinjalizuesit/bilbilfryrësit (*whistleblowers*); trajnime të zyrtarëve në lidhje me zbatimin e ligjit për sinjalizuesit e rasteve të korrupsionit; realizimi i fushatave ndërgjegjësuese për përdorimin e sistemeve të ndryshme që shmangin korrupsionin.

Gjithashtu, në këtë objektiv parashikohet “*nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat në denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit*”. Nxitja e publikut për përdorimin e mekanizmave dhe

---

[http://qbz.gov.al/botime/Fletore\\_Zyrtare/2015/PDF-2015/62-2015.pdf](http://qbz.gov.al/botime/Fletore_Zyrtare/2015/PDF-2015/62-2015.pdf)

55 Miratuar me VKM, Nr.691, Dt. 29.07.2015, Fletore Zyrtare nr. 147 faqe 10887 e disponueshme online në: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/147-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/147-2015.pdf)

56 Miratuar me VKM, Nr.247, Dt. 20.03.2015, Fletore Zyrtare nr. 47 faqe 2016 e disponueshme online në: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/PDF-2015/47-2015.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/PDF-2015/47-2015.pdf)



sistemeve të ankesave është një nga instrumentet më efikase në luftën kundër korrupsionit. Krijimi i besimit se këto mekanizma funksionojnë realisht do të ndikojë në rritjen e numrit të ankesave dhe denoncimeve duke ndikuar kështu pozitivisht në efikasitetin e luftës kundër korrupsionit. Në këtë mënyrë parashikohen si mekanizma nxitës krijimi i mjeteve elektronike për denoncimin e korrupsionit; publikimi online i të gjitha akteve nënligjore që parashikojnë procedurat e trajtimit të ankesave dhe afatet, dhe raportimi publik mbi rastet e trajtuara të korrupsionit.

**Strategjia për Mbrojtjen Sociale 2015-2020**<sup>57</sup> parashikon gjithashtu në pjesën e zhvillimit të shërbimeve të kujdesit social, ndërgjegjësimin dhe edukimin publik për parandalimin e problemeve sociale dhe adresimin pranë shërbimeve sociale, nëpërmjet fushatave të komunikimit, deri më 2018-n.

**Strategjia Kombëtare Për Luftën Kundër Trafikimit të personave 2014-2017**<sup>58</sup> parashikon si një nga shtyllat kryesore të saj “Parandalimin“ dhe në këtë kuadër, si strategjia ashtu dhe plani i veprimit, vënë theksin mbi punën që duhet bërë kryesisht nga strukturat lokale antitrafikim dhe shoqëria civile për ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut lidhur me këtë çështje, në tërësi, por dhe me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar antitrafikim, në veçanti. Në planin e veprimit i jepet rëndësi sipas seksioneve të vecanta informimit të publikut lidhur me parashikimet ligjore për punësimin e sigurt, strehimin social, të drejtën që viktimat e trafikimit kanë për dëmshpërblim, për mbrojtje të veçantë si dëshmitarë, për ndihmë financiare, përfaqësim ligjor etj.

**Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm**<sup>59</sup> ka thelbësisht objektiva të cilat synojnë ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimin e përfshirjes së grupeve të caktuara të publikut në një fenomen të tillë. Konkretisht, parashikohet se qeveria do të përmirësojë komunikimin me publikun për të rritur ndërgjegjësimin mbi radikalizimin dhe kërcënimet që e shoqërojnë. Përmes kanaleve të qarta dhe efektive të komunikimit, qoftë në internet ose jashtë tij, duke shfrytëzuar zëra të besueshëm, si udhëheqës komunitarë, autoritete fetare dhe të tjerë që shërbejnë si model, qeveria kërkon të ndërmjetësojë ligjërimin publik, të fuqizojë komunitetet lokale me informacion, të rrëzojë mitet dhe t’u japë përgjigje shqetësimeve të ndryshme që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Këto përpjekje do të shërbejnë për veçimin e ekstremizmit të dhunshëm nga çdo grup i caktuar fetar, duke e vënë theksin te trashëgimia e pasur kulturore dhe toleranca fetare e Shqipërisë. Më tej, në këtë strategji propozohen masa konkrete të tilla si propozimi i një strategjie krijuese dhe novatore komunikimi me publikun, si plotësuese e Strategjisë Kombëtare. Me anë të kësaj mase, qeveria shqiptare do të hartojë

57 Miratuar me VKM, Nr.1071, Dt. 23.12.2015, Fletore Zyrtare nr. 239 faqe 16304 e disponueshme online në: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2015/12/239.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/239.pdf)

58 Miratuar VKM. Nr. 814, date 26/11/2014

59 Miratuar me VKM, Nr.930, Dt. 18.11.2015, Fletore Zyrtare nr. 203 faqe 13247 e disponueshme online në: [http://www.mb.gov.al/files/documents\\_files/Strategjia\\_Kombetare\\_për\\_Luftën\\_kundër\\_Ekstremizmit\\_të\\_dhunshëm\\_dhe\\_Planit\\_të\\_Veprimit.pdf](http://www.mb.gov.al/files/documents_files/Strategjia_Kombetare_për_Luftën_kundër_Ekstremizmit_të_dhunshëm_dhe_Planit_të_Veprimit.pdf)

një mesazh që synon ta mbajë publikun të informuar për mënyrën se si mund të kontribuojë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

**Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016-2020**<sup>60</sup> kërkon marrjen e masave me qëllim informimin e publikut nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese si për të drejtat e grave ashtu dhe për luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Strategjia tërheq vëmendjen se gjatë vënies në funksionim apo fuqizimit të këtyre shërbimeve, duhet të mbahet në konsideratë edhe detyrimi për ofrimin e informacionit në përshtatje me nevojat e grupeve të veçanta.

### II.3 Parashikimet e legjislacionit të brendshëm

ELP-ja parashikohet në një sërë aktesh ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Këto ligje kanë sanksionuar detyrime për institucionet kushtetuese, por jo vetëm, për të kontribuar në përmirësimin e njohurive të qytetarëve mbi aspekte specifike të legjislacionit. Për të krijuar një panoramë më të qartë të korpusit normativ, që rregullon aspekte të caktuara të ELP-së, më poshtë janë listuar ligjet e posaçme:

**Kushtetuta**, në nenin 23 parashikon të drejtën për informim, si një e drejtë themelore e cila konsiston në detyrimin për transparencë të organeve të administratës publike dhe personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

**Kodi i Procedurave Administrative** vepron në bazë të parimit të informimit, sipas së cilit çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces. Nje parim tjetër i rëndësishëm është edhe ai i dhënies së ndihmës aktive sipas së cilit organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë që të jetë e mundur. Organi publik informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

**Kodi i Procedurës Penale** sanksionon detyrimin e organeve kompetente për të informuar viktimat në lidhje me të drejtat e tyre. Roli i koordinorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore paraqet një rëndësi të vecantë në këtë drejtim.

<sup>60</sup> Miratuar me VKM, Nr.733, datë 20.10 2016, Fletore Zyrtare nr. 201 faqe 21751 e disponueshme online në: [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2016/PDF-2016/201-2016.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/201-2016.pdf)



**Ligji Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"** rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, si dhe synon garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj parashikon detyrimin e çdo institucioni të administratës publike në nivel qendror dhe vendor që të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

**Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik"** përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Në kuadër të zbatimit të këtij ligji, është krijuar edhe Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENjK), i cili është një portal që shërben si një pikë qendrore konsultimi, nëpërmjet të cilit sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara.

**Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"** i ndryshuar, rregullon përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale. Ky proces duhet të bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private. Ky ligj sanksionon ndër të tjera se Komisioneri për Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyr dhe monitoron në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Zyra e Komisionerit nxit parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit, monitoruar zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, si dhe kryerjen e sondazheve.

**Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"**, i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike, mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ky ligj parashikon detyrimin e ndërgjegjësimit mbi përmbajtjen e këtij ligji nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, drejtuesit e institucioneve arsimore, si dhe punëdhënësit në lidhje me diskriminimin në punë.

**Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore"** parashikon se qëllimi i tij është mbrojtja efikase nga çdo sjellje që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë. Sipas këtij ligji, ministria përgjegjëse për çështjet sociale, vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera, ndërton dhe realizon veprimtari për edukimin, trajnimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe punonjësve e funksionarëve të administratës publike e sistemit gjyqësor mbi konceptin e barazisë gjinore, mosdiskriminimin e gruas, eliminimin e stereotipave gjinorë. Gjithashtu, subjektet, që

ofrojnë arsimim, kualifikim e trajnim, si dhe ata që formulojnë tekstet, programet dhe materialet e tjera mësimore, në të gjitha nivelet, sigurojnë mësimdhënien e njohurive të nevojshme dhe përdorin metoda mësimdhënieje, trajnimi e kualifikimi, në mënyrë të tillë që të ndihmojnë në promovimin, nxitjen dhe formimin e edukatës së barazisë dhe në ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, të stereotipave negativë, paragjytimeve dhe praktikave zakonore ose të çdo lloji tjetër, që cenojnë parimet e barazisë gjinore.

**Ligji nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit"** (i ndryshuar) parashikon organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit. Sipas këtij ligji, ky institucion, është nxitës i vendosjes dhe respektimit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend.

**Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"** ka qëllim garantimin e mirëqenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesin efektiv për fëmijën, shëndeti dhe mirëqenia e të cilit janë në rrezik. Ligji parashikon marrjen e një sërë masash parandaluese, fushatave ndërgjegjësuese dhe hartimin e kurrikulave për informimin në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

**Ligji nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit"** përmban parashikime të posaçme për të miturit të përfshirë në proceset penale. Qëllimi i tij është të garantojë masa edukative dhe parandaluese për të miturit që kryejnë vepra penale dhe të sigurojë ngritjen e mekanizmave mbikëqyrës për zbatimin e tyre.

**Ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"** hedh themelet e qasjes në drejtësi dhe marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun. Ligji i ngarkon përgjegjësinë Këshillit të Lartë Gjyqësor që të krijojë, zhvillojë dhe mirëmbajë portalin elektronik me qëllim ofrimin e informacionit të nevojshëm për qasje në drejtësi, përfshirë informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, ndihmën juridike, tarifat dhe mjetet alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ky organ mundëson që çdo gjykatë të ketë mundësi të hapësirën e saj informuese. Gjithashtu, Këshilli vendos që një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun, si dhe cakton të paktën një gjyqtari për mediat për çdo juridiksion apeli. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton dhe bën publike standardet e etikës gjyqësore dhe të rregullave të sjelljes të gjyqtarëve, si dhe për mbikëqyr respektimin e tyre. Këshilli cakton një Këshilltar për Etikën nga radhët e gjyqtarëve që ka përvojë dhe njohuri mbi çështje të etikës, i cili harton, publikon dhe përditëson vazhdimisht një manual informues, i cili përmban pyetje dhe përgjigje mbi dilemat etike, bazuar në standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Aktet normative nënligjore të Këshillit botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit si dhe në Fletoren Zyrtare

Këshilli i Lartë i Prokurorisë në raportin e përvitshëm para Kuvendit raporton mbi gjendjen e sistemit, mbi veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij, si dhe paraqet rekomandimet për përmirësimet e nevojshme. Raporti publikohet në faqen zyrtare të Këshillit, si dhe me çdo mënyrë tjetër që vlerësohet e përshtatshme nga Këshilli. Këshilli cakton një Këshilltar për Etikën nga radhët e prokurorëve që ka përvojë dhe njohuri mbi çështje të etikës, i cili harton, publikon dhe përditëson vazhdimisht një manual informues, i cili përmban pyetje dhe përgjigje mbi dilemat etike, bazuar në standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në ushtrim të funksioneve të tij, nxjerr akte normative nënligjore me efekt të përgjithshëm detyrues mbi të gjithë prokurorët, administratën e prokurorisë, personat privatë dhe organet publike. Aktet normative nënligjore botohen në faqen zyrtare të internetit të Këshillit dhe në Fletoren Zyrtare

**Ligj 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"** vendos rregullat e funksionimit të shërbimeve për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Këto struktura kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe legjislativin për të drejtën e informimit. Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun si koordinator, në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun.

**Ligji nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"** parashikon funksionimin e Prokurorisë së Posaçme dhe Njësisë së Pavarur Hetimore për të hetuar veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ky ligj parashikon funksionet e Koordinatorit për Marrëdhëniet me Mediat të Prokurorisë së Posaçme. Ky koordinator është i ngarkuar me detyrimin e informimit të publikut për format e rrezikut, pasojat e korrupsionit dhe të krimin të organizuar, si dhe për metodat e instrumentet për parandalimin e tij.

**Ligji nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"** parashikon mënyrën e komunikimit të prokurorisë me mediat. Konkretisht, prokuroria bën informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e saj, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen nën drejtimin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe mbikëqyrjen prej tij.

**Ligji nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"** sanksionon se institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë Ministri i Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe gjykatat. Ligji parashikon si forma të ofrimit të ndihmës juridike atë parësore dhe atë dytësore. Ndihmë juridike parësore është: i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë

jashtëgjyqësor; ii) dhënia e këshillimit; iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore<sup>61</sup>. Ndihma juridike parësore jepet nga punonjësit me trajnim të posaçëm, nga organizatat jo-fitimprurëse të autorizuar dhe nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

**Ligji nr.9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve"** i ndryshuar, i cili synon mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në treg, si dhe përcaktimin e rregullave dhe ngritjen e institucioneve përkatëse për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve, parashikon ndër të tjera edhe zhvillimin e fushatave për ndërgjegjësimin e konsumatorëve, sensibilizimin dhe njoftimin e vazhdueshëm të tyre.

**Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"** ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Në bazë të këtij ligji ministria përgjegjëse për çështjet sociale harton dhe ndërmerr fushata ndërgjegjësimi që inkurajojnë ndihmën, punën vullnetare dhe format e tjera të mbështetjes në favor të individëve dhe familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

**Ligji nr. 121/2014 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"** sanksionon se Qendra Pritëse për azilkërkuessit në bashkëpunim me subjekte të tjera, private apo shtetërore, vendase apo të huaja, në përputhje me të drejtat e azilkërkuessve e të refugjatëve, zhvillon programe pedagogjike e edukuese, si dhe këshillim ligjor falas. Gjithashtu, neni 49 i ligjit parashikon se refugjatët gëzojnë të drejtën për arsim njëlloj si shtetasit shqiptar. Ndër të tjera, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët organizon kurse të edukimit qytetar të tyre.

**Ligji nr.108/2014 "Për policinë e Shtetit"** (i ndryshuar) synon ruajtjen e rendit e të sigurisë publike dhe garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Ky ligj parashikon ndër të tjera se një ndër funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë së Shtetit është organizimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun.

**Ligji Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"** përcakton parimet bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar

<sup>61</sup> "Ndihmë juridike dytësore" është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.

në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar.

**Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar)** vendos detyra konkrete për administratën tatimore në lidhje me nxitjen e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore.

**Ligji Nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar)** parashikon që operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, garantojnë, ndër të tjera, edhe të drejtën e informimit të publikut.

**Ligj nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë" (i ndryshuar)** parashikon ndër kompetencat e Dhomës Kombëtare të Noterisë organizimin e kualifikimit të vazhdueshëm të noterëve, ndjekjen dhe kontrollin e kryerjes së stazhit, si dhe siguron rritjen e kualifikimit të asistentëve.

**Ligji nr. 9109, datë 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar)** parashikon ngritjen e Shkollës Kombëtare të Avokatisë, e cila është organi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që merret me përgatitjen e programeve të trajnimit, organizimin dhe administrimin e trajnimit fillestar të kandidatëve për avokat dhe trajnimin e vazhduar të avokatëve. Shkolla ka si objekt, ndër të tjera, hartimin dhe promovimin e programeve mësimore dhe kërkimeve në fushën e trajnimit dhe të zhvillimit profesional, si dhe organizimin dhe drejtimin e funksionalitetit dhe didaktikës së mësimdhënies për trajnimin profesional.

**Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" (i ndryshuar)** parashikon ndër të tjera se një nga funksionet e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve është edhe informimi i publikut për veprimtarinë e ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe për mundësitë e kontaktimit të ndërmjetësve. Gjithashtu, ligji parashikon se gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht njofton, udhëzon dhe, sipas rastit, informon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes.

**Ligj Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"** parashikon detyrimet për informim që mbartin organet e qeverisjes vendore në lidhje me veprimtarinë dhe vendimmarrjen e tyre. Në bazë të këtij ligji, çdo NjQV është e detyruar të caktojë koordinatoren e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses për të gjithë, veçanërisht për shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

**Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”** parashikon detyrimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në kuadër të ofrimit të këshillimit dhe mbështetjes në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe detyrimin e tij për të ndërgjegjësuar publikun për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit, si dhe të rrisë pranimin kulturor të sinjalizimit. ILDKPKI-ja publikon çdo vit raport për zbatimin e këtij ligji. Në këtë informacion përfshihen numri i rasteve të sinjalizuara, rezultatet e rasteve, shkalla e ndërgjegjësimit dhe besimit të mekanizmat e sinjalizimit nga publiku, koha e përcaktuar për shqyrtimin e rasteve dhe zbatimin e mekanizmave të mbrojtjes nga hakmarrja.

**Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”** parashikon detyrimin e Komitetit për Pakicat Kombëtare në lidhje me organizimin e aktiviteteve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare dhe forcimin e dialogut me shoqatat e pakicave kombëtare.

**Ligj nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"** sanksionon se autoritetet publike, fusha e veprimt të cilave përfshin funksione të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, brenda kompetencave të tyre, nxitin informimin, ndërgjegjësimit dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Ligji nr 93/2015, datë 27.07.2015, “ Për turizmin” i ndryshuar,** parashikon se Ministria përgjegjëse për turizmin nxit edukimin e të gjithë shtresave të popullsisë për turizmin si industri, njohjen e historisë, kulturës, bukurive natyrore, traditave fetare, artizanatit dhe vënien e tyre në shërbim të turizmit, duke bashkëpunuar me ministrinë përgjegjëse dhe me institucione të tjera publike e private, që veprojnë në fushat përkatëse. Ndërkohë që parashikon këtë përgjegjësi, ligji nr 93/2015 shkon edhe më tej duke parashikuar konkretisht format që mund të përdoren për të nxitur edukimin e shtresave si përfshirjen në fushata ndërgjegjësimit, përfshirjen e çështjeve të turizmit si sektor i rëndësishëm ekonomik në të gjitha ciklet e sistemit arsimor, nxitjen e kurseve të trajnimit profesional në shkolla dhe qendra të formimit profesional dhe dhënien e çmimeve kombëtare të suksesit apo të ekselencës për shërbimet në fushën e turizmit, sipërmarrjeve turistike apo individëve të veçantë.

**Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar,** ngarkon autoritetet përgjegjëse të përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të: a) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t’u drejtohet; b) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimit në qendrat dhe institucionet përkatëse.

Në zbatim të këtij ligji, pranë çdo bashkie caktohet koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore, i cili mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuese për dhunën.

**Ligji nr. 9970, datë 24 07.2008 « Për barazinë gjinore në shoqëri »** parashikon detyrimin ligjor për informim ligjor të publikut për çështjet e barazisë gjinore dhe eliminimin e dhunës në familje. Autoritetet shtetërore përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore duhet të realizojnë veprimtari për edukimin, trajnimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe punonjësve e funksionarëve të administratës publike e sistemit gjyqësor mbi konceptin e barazisë gjinore, mosdiskriminimin e gruas, eliminimin e stereotipave gjinorë, kuptimin e drejtë të rolit të femrës e të mashkullit, të nënës e të babait në familje dhe shoqëri.

#### **II.4 Kuadri institucional dhe përgjegjësitë e institucioneve në kuadër të ofrimit të Edukimit Ligjor të Publikut**

Nga dokumenti analitik i sistemit të drejtësisë sugjerohet që një sërë institucioneve shtetërore kanë detyrë të angazhohen me ELP-në. Rrjedhimisht, pjesë e kësaj pasqyre është analiza e kuadrit institucional në këndvështrimin e përgjegjësive dhe detyrave që legjislacioni në fuqi i njeh institucioneve të caktuara në ofrimin e ELP-së.

**Kuvendi i Shqipërisë** nëgjithw veprimtarinw e tij , mbart detyrimin për të bërë transparente dhe për të informuar vazhdimisht publikun mbi këtë veprimtari. Kuvendi i ka siguruar publikut komunikim të vazhdueshëm nëpërmjet shërbimeve të tij, duke përgatitur në kohë reale dhe me transparencë të plotë aktivitetet parlamentare.

Byroja e Kuvendit, me Vendim Nr. 17, Datë 11.11.2014, ka miratuar “Manualin e pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit”, i cili është një burim për të nxitur dhe siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në funksionin legjislativ dhe atë mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë. Pjesëmarrja, sidomos e shoqërisë civile në procesin ligjvënës të Kuvendit i shërben përmirësimit të cilësisë së legjislacionit të shqyrtuar dhe miratuar. Ajo merr rëndësi të veçantë kur diskutohen çështje që kanë të bëjnë me grupe në nevojë si personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, minoritetet, etj. Ky manual, synon t’i japë mundësinë publikut që, që nga qytetari më i thjeshtë e deri tek organizatat jofitimprurëse të informohen dhe shndërrohen në pjesëmarrës aktivë të zhvillimit të komunitetit ku bëjnë pjesë dhe në ofrues të përmirësimit të politikave ligjore, nga të cilat preken.

Në këtë manual, pjesëmarrja e publikut është trajtuar në kuptim të: informimit, konsultimit, dialogut dhe partneritetit.

##### *Informimi*

E drejta për informim është baza e përfshirjes së publikut në procesin ligjvënës dhe të kontrollit të zbatimit të legjislacionit. Kjo e drejtë garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji për të drejtën e informimit për dokumente zyrtare. Informimi konsiston në ofrimin e njëanshëm të informacionit nga Kuvendi i Shqipërisë pa qenë nevoja për ndërveprim apo përfshirje të subjektit kërkues të informacionit.

### *Konsultimi*

Kjo është ajo formë e bashkëpunimit, ku organet e Kuvendit u kërkojnë përfaqësuesve të shoqërisë civile mendimin e tyre për një projektligj apo rreth një çështjeje të caktuar. Nisma dhe tema e konsultimit del nga organet e Kuvendit.

### *Dialogu*

Nisma për dialog mund të merret si nga organet e Kuvendit, ashtu edhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Dialogu siguron shkëmbimin e pikëpamjeve për një çështje të caktuar apo gjatë shqyrtimit të një projektligji.

### *Partneriteti*

Partneriteti përfshin përgjegjësi të përbashkëta në çdo hap të procesit të vendimmarrjes politike, dhe është forma më e ngushtë e bashkëpunimit me shoqërinë civile. Manuali synon që të jetë një instrument interaktiv, i dobishëm dhe udhërrëfyes si për publikun ashtu edhe për deputetët e administratën e Kuvendit, për të siguruar pjesëmarrjen e vazhdueshme dhe sistematike të publikut në procesin vendimmarrës.

Bashkëpunimi i organeve të Kuvendit me publikun zhvillohet për çështje që kanë të bëjnë me kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi, gjatë shqyrtimit të projektligjeve, apo për çështje që lidhen me veprimtarinë e Kuvendit me karakter edukues, promovues, shkencor, etj.

Veprimtaria e Kuvendit është e hapur dhe transparente, dhe realizohet nëpërmjet:

- a) pjesëmarrjes së publikut në procesin ligjvënës;
- b) pasqyrimit të veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij në median e shkruar dhe vizive;
- c) botimeve të dokumentacionit parlamentar;
- ç) faqes së internetit të Kuvendit;
- d) rrjetit të brendshëm audiovizual.

Gjithashtu, në kuadër të funksionit monitorues të Kuvendit, në bazë të ligjit nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian“, ky organ është përgjegjës për informimin e publikut për ecurinë e etapave të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile të përfshirë në këtë proces. Madje, në faqen zyrtare të internetit, Kuvendi krijon një rubrikë të veçantë për informimin e publikut për çështjet e integritit evropian.

**Presidenti i Republikës**, në kushtet e mungesës së një ligji organik për institucionin e Presidentit të Republikës që të parashikojë shprehimisht ushtrimin e kompetencave të caktuara atij nga Kushtetuta, është një institucion i cili nuk mbart detyrime specifike në lidhje me edukimin ligjor të publikut.



**Avokati i Popullit** në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (i ndryshuar) ka në mision mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai është nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend. Në kryerjen e funksioneve të veta, Avokati i Popullit bashkëpunon ngushtë me organizatat jofitimprurëse, duke marrë periodikisht mendimet e tyre për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut. Në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, organizon, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë.

**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Pjesë e funksioneve të tij është nxitja e parimit të transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit dhe monitoruar zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Gjithashtu në Strategjinë Për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale 2018-2020, mbetet në vëmendje qasja ndërgjegjësuere ndaj subjekteve të të dhënave personale për të kuptuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi** në bazë të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ka ndër kompetencat e tij nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke realizuar sensibilizim dhe informim për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, ai ka detyrë të informojë për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje.

**Gjykata Kushtetuese** është organi i cili zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Në bazë të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 (i ndryshuar) nuk parashikohen detyra specifike në lidhje me ELP-në por në nenin 26.1 të ligjit parashikohet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese publikohen në Fletoren Zyrtare si dhe në mjete të tjera të informimit publik.

**Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)** është ngritur në bazë të Kushtetutës dhe ligjit nr. 115/2016 "Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë". Ky institucion është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun. Ky institucion ka detyrë të lançojë një portal *online* me qëllim ofrimin e informacionit të nevojshëm për qasje në drejtësi, natyrën dhe qëllimin e proceseve gjyqësore, ndihmën juridike, tarifat dhe mjetet alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu, ky institucion ka detyrë të marrë masa që publiku dhe palët e interesuara të informohen mbi

veprimtarinë e gjykatave. Një anëtar i KLGJ-së është përgjegjës për marrëdhëniet me publikun, të cilat duhet të bazohen në parimet e së drejtës për qasje në informacion.

**Gjykatat** si organe pushteti që ushtrojnë dhënien e drejtësisë janë të ngarkuara, ndër të tjera, me detyrimin e informimit të publikut, si dhe lehtësimin e qasjes në drejtësi. Në bazë të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" në portalin elektronik që krijon Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi, përfshihet informacion i detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik. Secila gjykatë, në hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet, publikon të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore. Të paktën një gjyqtar për mediat caktohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për çdo juridiksion apeli. Gjithashtu, në bazë të Ligjit 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", në gjykata krijohen shërbimet për marrëdhëniet me publikun, të cilat kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe legjislacionin për të drejtën e informimit. Përpos funksioneve të informimit të publikut mbi punën e saj, gjykata është ngarkuar në bazë të Kodit të Procedurës Civile me detyrimin për të informuar të paditurin për sa i përket përmbajtjes së nevojshme të deklaratës së mbrojtjes, në lidhje me mundësinë për të kërkuar ndihmë ligjore dhe pasojat ligjore në rast moslëshimi të deklaratës së mbrojtjes.

**Këshilli i Lartë i Prokurorisë** është krijuar në bazë të Kushtetutës dhe ligjit nr.115/2016 "Për qeverisjen e sistemit të drejtësisë". Në këtë ligj parashikohet se ky institucion ka një strukturë për marrëdhëniet me publikun, por nuk përmban detyrime konkrete për ELP-në.

**Prokuroria** sipas Ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" bën informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtarinë e saj, duke respektuar procesin hetimor. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen nën drejtimin e prokurorit të caktuar për marrëdhëniet me publikun dhe mbikëqyren prej tij.

**Prokuroria Posaçme** në bazë të Ligjit nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", përmes Koordinatorit për Marrëdhëniet me Mediat, informon publikun për format e rrezikut, pasojat e korrupsionit dhe të krimin të organizuar, si dhe për metodat e instrumentet për parandalimin e tij.

**Banka e Shqipërisë** funksionon në bazë të dispozitave kushtetuese dhe ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", dhe kryen veprimtari edukuese mbi legjislacionin ekonomik në Shqipëri, por më tepër mban në fokus fushën e edukimit ekonomiko-financiar, për krijimin e një kulture të mirëfilltë financiare në shoqërinë tonë. Një kulturë e tillë ndihmon konsumatorët,

prodhuesit dhe investuesit të marrin vendime të goditura financiare dhe njëkohësisht Bankën e Shqipërisë që të arrijë më lehtë objektivin e saj për arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

**Këshilli i Ministrave** në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” nuk ka detyrime ligjore të specifikuar në lidhje me edukimin ligjor të publikut. Ndërkohë në bazë të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj në sistemin arsimor, ndër të tjera duke përfshirë informacion për programet mësimore.

**Ministria e Drejtësisë (MD)** funksionon mbi bazën e ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” (të ndryshuar). Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, MD ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë. Sipas këtij Ligji, ajo mbështet realizimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë, sipas parashikimeve të ligjeve të posaçme në fushën përkatëse. Ministria e Drejtësisë kujdeset dhe mbështet veprimtaritë shkencore në fushën e drejtësisë dhe përhapjen e edukatës juridike, si dhe kujdeset për ndjekjen dhe bashkërendimin e marrëdhënieve me shoqërinë civile për fushën e drejtësisë. Pranë kësaj ministrie veprojnë dy qendra informimi ligjor përkatësisht, qendra për viktimat dhe klinika e ligjit. Kjo e fundit synon të kryejë disa funksione si orientimin e qytetarit për identifikimin e saktë të problemit, institucionit që duhet t'i drejtohet dhe formës nëpërmjet së cilës duhet të kërkojë shërbimin; asistimin në hartimin e shkresave dhe kërkesave sipas nevojës së qytetarit lidhur me ankesat me shkrim në marrëdhënie me administratën publike dhe gjyqësore; dhënien e informacionit parësor mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë qytetarët; këshillimin ligjor mbi ndihmën juridike falas dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim etj.

**Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme** në bazë të ligjit nr.23/2015 "Për shërbimin e jashtëm" është institucioni drejtues i Shërbimit të Jashtëm dhe harton, përpunon, koordinon, bashkërendon dhe zbaton politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë në përputhje me interesat kombëtarë. Në bazë të “Strategjisë së Luftës kundër Trafikimit të Personave 2014-2017" kjo ministri duhet të këshillojë dhe informojë qytetarët shqiptarë jashtë vendit nëpërmjet stafit konsullor, të ofrojë asistencë konkrete për viktimat e mundshme të trafikimit, si dhe për dhënien e informacionit për legjislacionin e punës dhe të drejtat, dhe ndihmë për zbulimin e kontratave të punës të rreme.

**Ministria përgjegjëse për arsimin** në bazë të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) miraton dokumentacionin kurrikular. Gjithashtu, në bazë të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ministri që mbulon fushën e

arsimit, është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj në sistemin arsimor, ndër të tjera duke përfshirë informacion për të në programet mësimore. Në bazë të Ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore" subjektet, që ofrojnë arsimim, kualifikim e trajnim, si dhe ata që formulojnë tekstet, programet dhe materialet e tjera mësimore, në të gjitha nivelet, sigurojnë mësimdhënien e njohurive të nevojshme dhe përdorin metoda mësimdhënieje, trajnimi e kualifikimi, në mënyrë të tillë që të ndihmojnë në promovimin, nxitjen dhe formimin e edukatës së barazisë dhe në ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, të stereotipave negativë, paragjykimeve dhe praktikave zakonore ose të çdo lloji tjetër, që cenojnë parimet e barazisë gjinore. Gjithashtu, në bazë të Kodit Rrugor, Ministri i Arsimit dhe Sportit, me urdhëresë të tij, disiplinon mënyrat e zbatimit në shkolla të programeve të sipërpërmendura, edhe me ndihmën e policisë rrugore, si dhe të personelit ekspert që bën pjesë në institucionet e sipërpërmendura publike e private. Ky akt mund të parashikojë ngritjen e kurseve të posaçme për mësimdhënësit që bashkëpunojnë për zbatimin e këtyre programeve.

**Ministria përgjegjëse për punët e brendshme** në bazë të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" është përgjegjëse për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj te punëmarrësit dhe punëdhënësit duke dhënë informacion për këtë ligj.

**Ministria përgjegjëse për çështjet sociale** në bazë të Ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" ka si detyrë rritjen e ndërgjegjësimit duke dhënë informacion për këtë ligj. Gjithashtu, në bazë të Ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore", kjo ministri, vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera, ndërton dhe realizon veprimtari për edukimin, trajnimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe punonjësve e funksionarëve të administratës publike e sistemit gjyqësor mbi konceptin e barazisë gjinore, mosdiskriminimin e gruas, eliminimin e stereotipave gjinorë. Në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" ministria që mbulon çështjet sociale është e ngarkuar me hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe organizimin e kurseve të trajnimit rreth dhunës në familje me punonjësit e shërbimeve sociale, që janë të atashuar pranë çdo njësie vendore, strukturat e Policisë së Rendit dhe me punonjësit e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Në kuadër të ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" kjo ministri harton dhe ndërmerret fushata ndërgjegjësimi që inkurajojnë ndihmën, punën vullnetare dhe format e tjera të mbështetjes në favor të individëve dhe familjeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

**Ministria përgjegjëse për infrastrukturën** në marrëveshje me Ministrinë e Punëve të Brendshme, në bazë të Kodit Rrugor dhe për të nxitur formimin e të rinjve në fushën e sjelljes rrugore dhe të sigurisë së trafikut e të qarkullimit, duke shfrytëzuar bashkëpunimin me ente dhe shoqëri me përvojë të gjerë në sektorin e parandalimit dhe sigurisë rrugore të përcaktuara me aktet e ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse, parapërgatitin, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij Kodi,

programet e posaçme, të pajisura me planin përkatës financiar, për t'u kryer si veprimtari e detyrueshme në shkolla të çdo lloji dhe grade, ku përfshihen dhe institutet artistike dhe shkollat, që përmbledhin njohjen e parimeve të sigurisë rrugore, si dhe të rrugëve, të sinjalizimit, të normave të përgjithshme për drejtimin e mjeteve dhe të rregullave të sjelljes të përdoruesve.

**Ministria përgjegjëse për fushën e tregtisë**, në bazë të ligjit nr.9902 datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve " është përgjegjëse për zhvillimin e fushatave për ndërgjegjësimin e konsumatorëve, sensibilizimin dhe njoftimin e vazhdueshëm të tyre.

**Komiteti për Pakicat Kombëtare në bazë të Ligjit nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë"** organizon aktivitete me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin për mbrojtjen e promovimin e të drejtave të pakicave kombëtare dhe forcimin e dialogut me shoqatat e pakicave kombëtare, si edhe financon, nëpërmjet fondit për pakicat kombëtare, nismat dhe projektet që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe ruajtjen e promovimin e identitetit kombëtar, gjuhësor e kulturor të pakicave kombëtare.

**Shkolla Shqiptare e Administratës Publike**, e themeluar me Ligjin 152/ "Për nëpunësin civil", ka për qëllim formimin profesional të nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër, vendas ose të huaj, që nuk është pjesë e shërbimit civil dhe që plotëson kriteret e kërkuara. Formimi profesional realizohet në formën e trajnimeve për njohuritë mbi legjislacionin përkatës si dhe për aftësimin e të trajnuarëve për të ushtruar funksionet e tyre në institucionet e administratës publike. Gjithashtu, ajo realizon studime dhe botime në fushën e administratës publike.

**Qendra e Botimeve Zyrtare** funksionon në bazë të Ligjit 78/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare". Kjo Qendër është ekskluzivisht përgjegjëse për botimin e saktë dhe brenda afateve ligjore të akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në Arkivin Elektronik të Akteve, si dhe për garantimin e mirëfunksionimit të këtij të fundit. Ligji për Qendrën e Botimeve Zyrtare synon aksesin efektiv në legjislacionin online në Republikën e Shqipërisë për njohjen e legjislacionit dhe ushtrimin e së drejtës për informim të personave fizikë dhe juridikë dhe institucioneve shtetërore.

**Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** sipas ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, ka në varësi institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale që kanë për detyrë rehabilitimin social të të burgosurve. Gjithashtu, në bazë të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, çdo i paraburgosur apo i dënuar informohet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij që rrjedhin nga ligji, rregullorja dhe rregullorja e brendshme e IEVP-së. Për këtë qëllim, i vihen në dispozicion aktet e nevojshme ligjore e nënligjore. Plani i ri-integrimit të të dënuarve përfshin, ndër të tjera, edhe edukim dhe arsimim. Bibliotekat në institucion duhet të ketë literaturë për të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve, legjislacionin bazë penal, procedural penal dhe në fushën e trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve. Një trajtim të

veçantë u garantohet të miturve të pranuar në institucionet e paraburgimit ose vuajtjes së dënimit. Në momentin e pranimit, të miturit informohen për rregulloren e brendshme të institucionit dhe për të drejtat dhe detyrimet e tij në një gjuhë dhe mënyrë të kuptueshme.

**Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit** në bazë të ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor" organizon dhe ndjek edukimin profesional dhe trajnimin e përmbarruesve gjyqësorë. Gjithashtu, në bazë të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, kjo Drejtori duhet të informojnë publikun për shërbimin përmbarrimor të ofruar.

**Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** mbi bazën e ligjit nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit" (i ndryshuar) është organi përgjegjës për organizimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun. Gjithashtu, në bazë të ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, brenda kompetencave, merr masa për parandalimin e përfshirjes së fëmijës në prodhimin, shpërndarjen dhe trafikimin e substancave narkotike, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe të fëmijës për këtë çështje, përfshirë edhe hartimin e kurrikulave të nevojshme për këtë qëllim.

**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve** dhe administrata tatimore në bazë të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, është përgjegjëse për nxitjen e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore.

**Avokati i Tatimpaguesëve** është një strukturë në varësi të Drejtërisë së Përgjithshme të Tatimeve, dhe bazuar në VKM Nr. 648 datë 28.07.2010 "Për Avokatin e Tatimpaguesit", në zbatim të legjislacionit tatimor, për të siguruar më shumë transparencë, përgjegjshmëri dhe integritet nga ana e administratës tatimore, Avokati i Tatimpaguesit garanton mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të tatimpaguesve. Avokati i Tatimpaguesve, gjithashtu, ndihmon në përhapjen e informacionit për të drejtat e tatimpaguesve dhe edukimin e tyre.

**ADISA (Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara)** bazuar në Ligjin 13/2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë" ndër të tjera, është përgjegjëse për dhënien e informacionit për procedurat administrative të përfitimit të shërbimit publik, nëpërmjet kanaleve të ndryshme moderne të komunikimit.

**Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** dhe administrata doganore sipas Kodit Doganor mbajnë kontakte të rregullta me operatorët ekonomikë dhe autoritetet e tjera, të përfshira në tregtinë

ndërkombëtare të mallrave. Ato promovojnë transparencën, duke bërë lirisht të disponueshëm pa pagesë dhe përmes internetit, legjislacionin doganor, aktet nënligjore dhe formularët e aplikimit.

**Instituti për Zhvillimin e Arsimit (IZHA)** është krijuar me VKM nr. 67, datë 10.02.2010 "Për krijimin e Institutit të Zhvillimit të Arsimit" ku parashikohet se misioni i IZHA-së është që t'u ofrojë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe institucioneve arsimore të të gjitha niveleve ekspertizë dhe këshillim me nivel të lartë profesional, të mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-shkencore studimore dhe praktikës së arsimit. Gjithashtu, ky Institut ka për detyrë, ndër të tjera, të ofrojë këshillim për nxënësit dhe qytetarët në fushën e arsimit të të gjitha niveleve, të zhvillojë metodologji dhe standarde për tekstet mësimore, si dhe të zhvillojë veprimtari informative për institucionet, nxënësit, studentët, punëdhënësit dhe punëmarrësit.

**Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës** në bazë të ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna. Ndër të tjera, ka si detyrë të koordinojë dhe të organizojë trajnime të edukimit vazhdues për punonjësit e mbrojtjes së fëmijës dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje, si dhe koordinon ose realizon fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete konkrete për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijës në të gjitha fushat.

**Autoriteti Kombëtar i Ushqimit** është institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i krijuar në bazë të VKM-së nr. 1081, datë 29.12.2010 (i ndryshuar) "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit". Ai informon publikun për fushën e sigurisë së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, mbrojtjes së bimëve të kontrollit për zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes të të drejtave të seleksionerit të bimëve, fushën e veprimtarive për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe cigareve, si dhe në fushën e veprimtarisë së prodhimit dhe tregtimit të materialit mbjellës e shumëzues bimor.

**Agjencia Kombëtare e Mjedisit** në bazë të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" është një institucion në varësi të ministrit përgjegjës për fushën e mjedisit dhe realizon sigurimin e informacionit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore për çdo operator, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

**Agjencia për Legalizimin dhe Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/Ndërtimeve Informale** në bazë të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin dhe urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" është përgjegjës për realizimin e fushatës kombëtare të informimit dhe të sensibilizimit të qytetarëve, në bashkëpunim me mjetet e informimit të gjerë publik.

**Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)** në bazë të ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)" në funksion të veprimtarisë së saj, kryen të gjitha veprimet dhe ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore.

**Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit** në bazë të VKM Nr. 673 datë 22.11.2017 "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit" është organi përgjegjës, ndër të tjera, për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike, duke përfshirë portalin, *e-albania*, regjistrin kombëtar të shërbimeve qeveritare, si dhe regjistrin e bazave të të dhënave shtetërore, si dhe është e ngarkuar me detyrën e promovimit të aksesit të publikut në shërbimet online.

**Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)** gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, duhet të sigurojë që të gjithë shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë, veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias. AMA garanton që çdo subjekt në këtë fushë angazhohet që të nxisë vlerat demokratike të përcaktuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe në veçanti të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit, si dhe të jetë përgjegjës në lidhje me interesat dhe ndjeshmërinë publike, të respektojë mirëkuptimin dhe bashkekzistencën shoqërore të të gjithë individëve në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, subjektet e licencuara në fushën e mediave audiovizive, u kërkohet nga AMA që të përfshijnë në përpjesëtim të arsyeshëm programet e lajmeve dhe ato me natyrë informative.

**Radio Televizioni Shqiptar** në bazë të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" është i ngarkuar me detyrën që të realizojë shërbime cilësore radioje dhe televizioni për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë dhe pakicat kombëtare. Një nga qëllimet e RTSH të përcaktuar në këtë ligj është të sigurojë një gamë të plotë të programeve në gjuhën shqipe që informojnë dhe edukojnë publikun dhe plotësojnë pritshmëritë e publikut në përgjithësi, si dhe të individëve, që i përkasin pakicave shoqërore.

**Organet e qeverisjes vendore.** Në bazë të Ligjit 114/2014 "Për ndarjen administrativo territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", njësitet e qeverisjes vendore organizohen në bashki dhe qarqe. Këto njësi funksionojnë në bazë të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Si një ndër aspektet themelore të misionit të organeve të qeverisjes vendore të parashikuar në këtë ligj është realizimi i shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë, si edhe nxitjen efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në



qeverisjen vendore, në përputhje me parimin e autonomisë vendore dhe të subsidiaritetit. Organet e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për informimin e publikut në çdo bashki, që realizohet përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim. Gjithashtu, në ligje të tjera specifike, siç është rasti i ligjit nr.18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", apo i ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, bashkia listohet si një ndër strukturat e mbrojtjes së fëmijës, dhe të mbrojtjes kundër dhunës në familje në nivel vendor.

Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për ngritjen dhe bërjen efektiv të mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe duhet të caktojnë koordinatorin vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i cili është përfaqësuesi i zyrës së shërbimeve sociale pranë asaj njësie të qeverisjes vendore, i cili mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuere për dhunën.

**Dhoma Kombëtare e Noterisë** në bazë të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 "Për noterinë" (i ndryshuar) organizon kualifikimin e vazhdueshëm të noterëve, si dhe ndjek dhe kontrollon kryerjen e stazhit dhe siguron rritjen e kualifikimit të asistentëve.

**Dhoma Kombëtare e Avokatisë** në bazë të ligjit nr. 9109, date 17.07.2003 "Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar) ushtron funksionet e edukimit dhe arsimimit përmes Shkollës Kombëtare të Avokatisë. Kjo e fundit ka si objekt, ndër të tjera, hartimin dhe promovimin e programeve mësimore dhe kërkimeve në fushën e trajnimit dhe të zhvillimit profesional si dhe organizimin dhe drejtimin e funksionalitetit dhe didaktikës të mësimdhënies për trajnimin profesional.

**Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve** në bazë të ligjit nr. 10.385, datë 24.02.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" (i ndryshuar) ndër të tjera, kujdeset për informimin e nevojshëm të publikut për veprimtarinë e ndërmjetësimit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe për mundësitë e kontaktimit të ndërmjetësve.

**Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë** në bazë të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat" (i ndryshuar) bashkërendon dhe përkrah nismat, që kanë si qëllim përmirësimin dhe ngritjen profesionale. Dhoma, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit duhet të informojnë publikun për shërbimin përmbauesor të ofruar.

**Institucionet e Arsimit të Lartë.** Në bazë të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ndër të tjera, ka për mision të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të

mbrojë dijet përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në këtë ligj nuk ka parashikime specifike mbi detyrimin që mbartin këto institucione në lidhje me edukimin ligjor të publikut. Ndërsa në bazë të legjislationit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe barazinë ligjore specifikohen detyra konkrete për institucionet e arsimit. Në bazë të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që duhet të merren, ndër të tjera, janë, rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda institucionit, duke afishuar ligjin në një vend të dukshëm. Gjithashtu, në ligjin nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore" subjektet që ofrojnë arsimim, kualifikim e trajnim, si dhe ata që formulojnë tekstet, programet dhe materialet e tjera mësimore, në të gjitha nivelet, sigurojnë mësimdhënien e njohurive të nevojshme dhe përdorin metoda mësimdhënieje, trajnimi e kualifikimi, në mënyrë të tillë që të ndihmojnë në promovimin, nxitjen dhe formimin e edukatës së barazisë dhe në ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, të stereotipave negativë, paragjyqimeve dhe praktikave zakonore ose të çdo lloji tjetër, që cenojnë parimet e barazisë gjinore.

**Organizatat e shoqërisë civile** krijohen funksionojnë në bazë të Kodit Civil si dhe ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", sipas të cilit ato ndjekin qëllime në të mirë dhe interes të publikut. Veprimtari në të mirë dhe interes të publikut, kuptohet çdo veprimtari që mbështet dhe zhvillon tek individit dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut. Në bazë të këtij rregullimi ligjor, të gjitha organizatat jofitimprurëse mund të angazhohen në lidhje me çështje të ELP-së, krahas formave të tjera të ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Organizatat e shoqërisë civile kanë qënë vazhdimisht të angazhuara dhe kanë ngritur kapacitetet e tyre në ofrimin e ELP-së.

## **II.5 Identifikimi i nevojave dhe fushave prioritare të Edukimit Ligjor të Publikut**

Edukimi ligjor i publikut nuk ka të bëjë me specializimin në një fushë të së drejtës, por me informimin e publikut të gjere me dijet e nevojshme mbi kuptimin e të përditshmes të së drejtës dhe rrugëdaljet më të shpejta ligjore ndaj cenimeve të të drejtave, çështje që janë bazike në një shoqëri demokratike, ku ligji është produkt i qytetarit dhe për qytetarin. Nëpërmjet zhvillimit të njohurive ligjore, si dhe rritjes së sigurisë që qytetarët ndiejnë në përdorimin e ligjit, edukimi ligjor publik kontribuon, gjithashtu, edhe në forcimin e një qytetarie më aktive dhe në një kohezion më të madh shoqëror<sup>62</sup>.

<sup>62</sup> Analiza e sistemit të drejtësisë fq. 215.

### ***II.5.1 Situata e deritanishme në lidhje me informimin dhe edukimin ligjor të publikut***

Nga analiza e kuadrit politik, ligjor, institucional si dhe nga vlerësimi i situatës aktuale rezultojnë gjetjet e mëposhtme:

#### ***II.5.1.1 Gjetjet nga analiza e dokumenteve strategjike***

Nevoja e publikut për edukim ligjor është evidentuar në disa dokumente strategjike të hartuar, në fusha të ndryshme, vitet e fundit. Megjithatë, pavarësisht përmbajtjes së strategjive e politikave në fuqi, deri më sot ELP-ja është realizuar, kryesisht, vetëm me anë të projekteve dhe iniciativave të organizatave jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë dhe me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. Nga Analiza e Sistemit të Drejtësisë janë vënë re mangësi në drejtim të mungesës së institucionalizimit të ELP-së dhe mungesës së institucioneve koordinuese ose përgjegjëse që nxisin, organizojnë dhe monitorojnë këtë veprimtari të rëndësishme. Për pasojë, është e nevojshme të ndërmerren hapa për zhvillimin e kulturës së zbatimit të ligjit përmes metodave të ELP-së dhe krijimit të institucioneve përkatëse për këtë qëllim<sup>63</sup>.

Është konstatuar se, edhe pse në disa raste ka aktivitete të institucioneve publike, të lidhura me ELP-në, nuk ka një veprimtari vijuese nga këto institucione. Po ashtu, jo të gjitha institucionet shtetërore kanë projekte e plane për të promovuar e mundësuar këtë formë edukimi. Deri më tani nuk ka patur asnjë strategji kombëtare për ELP-në, nuk ka një koordinim dhe planifikim të mirë, dhe as ndarje të detyrave institucionale dhe të shoqërisë civile për edukimin vazhdues ligjor të publikut.

Përsa i përket sistemit arsimor<sup>64</sup>, edukimi ligjor dhe edukimi për të drejtat e njeriut janë pjesë e lëndës “Qytetaria”, që zhvillohet në arsimin parauniversitar nga klasa 1-10. Përmbajtja e kësaj lënde përputhet me vizionin e Këshillit të Evropës, të konkretizuar në disa nga dokumentet strategjike, që trajtojnë njohuritë që duhet të përvetësojnë nxënësit e kësaj moshe. Kjo lëndë mësimore ofron dije, për nxënësit, në përputhje me moshën e tyre. Kurikula trajton, mes të tjerave, nocionin e rregullave dhe normave morale, si dhe përgjegjësinë shoqërore të çdo individi për të vepruar në përputhje me to, në të mirë të harmonisë dhe të bashkëjetesë paqësore në komunitet dhe interesit të përbashkët. Gradualisht kalohet në konceptin e ligjit dhe të të drejtave të njeriut, që trajtohen në mënyrë specifike në klasën e 7-të dhe klasën e 10-të (shkolla e mesme). Të drejtat trajtohen ngushtë me përgjegjësitë shoqërore. Në këtë fazë trajtohen dhe koncepte mbi legjislacionin që rregullon marrëdhëniet në familje, lidhur me arsimin, mjedisin, shëndetin, të drejtat e konsumatorit, sigurinë rrugore, marrëdhëniet e punës etj. Pavarësisht nga puna e bërë deri tani ky program mësimor për nxënësit e arsimit parauniversitar (të shkollës së mesme) ka vend që programi të rishikohet për t’u përshtatur më mirë me zhvillimet e fundit të legjislacionit dhe zhvillimeve politike, shoqërore e ekonomike në

<sup>63</sup> Strategjia e Reformës në Drejtësi fq. 28 dhe 29.

<sup>64</sup> “Edukimi ligjor dhe edukimi për të drejtat e njeriut në arsimin bazë dhe atë të mesëm”, Astrit Dautaj, Instituti për Zhvillimin e Arsimit.

vend, për të përcjellë koncepte më të plota në lidhje me funksionimin e shtetit dhe në lidhje me disa pjesë të legjislacionit që shërbejnë për të parandaluar fenomene të tilla si dhuna në familje e shoqëri, trafikimi i qenieve njerëzore, diskriminimi, disa koncepte mbi përgjegjësinë penale dhe marrëdhëniet juridiko-civile.

Analiza e Sistemit të Drejtësisë ka nënvizuar si nevojë përfshirjen e edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar dhe pasurimin e mëtejshëm të kurrikulave dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare të sistemit arsimor parauniversitar me elementë të edukimit ligjor në fushën e së drejtës penale, administrative, fiskale, civile dhe familjare, si edhe rishikimin e natyrës së informacionit që u ofrohet nxënësve duke e vënë theksin tek natyra juridike dhe jo vetëm në aspektin moralizues. Për rritjen e efektivitetit të edukimit ligjor të nxënësve është e nevojshme dhe përgatitja e përshtatshme e stafit pedagogjik me nivelin e domosdoshëm të njohurive juridike përmes përfshirjes së lëndëve të detyrueshme të edukimit ligjor në kurrikulat universitare të programeve të mësuesisë, si edhe përmes programeve të trajnimit vazhdues. Edukimi ligjor i nxënësve duhet bërë duke rritur njohuritë praktike mbi funksionimin e institucioneve vendimmarrëse, atyre ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe nxitjen e aktivizimit të publikut dhe rritjen e kohezionit social përmes informimit mbi mënyrat e pjesëmarrjes në vendimmarrje. Njohja me alternativat e zgjidhjes së konflikteve, larg vetëgjyqësisë dhe hakmarrjes, me qëllim parandalimin e kriminalitetit dhe të sjelljeve të kundërligjshme, sensibilizimin mbi avantazhet e zgjidhjes me ndërmjetësim dhe arbitrim të mosmarrëveshjeve përmes organizimit të fushatave masive edukative për publikun, janë gjithashtu tema që duhen trajtuar me nxënësit e shkollave, nënvizon Analiza e sipërcituar.

### ***II.5.1.2 Gjetjet nga analiza e kuadrit ligjor në fuqi***

Rezulton se kuadri ligjor ekzistues parashikon forma të ndryshme të ofrimit të ELP-së, duke përfshirë si informimin në bazë të legjislacionit për të drejtën e informimit, ashtu edhe ndërmarrjen e iniciativave konkrete për ta bërë më të prekshëm informacionin ligjor tek qytetarët, përmes fushatave ndërgjegjësuere dhe parandaluese, përfshirë dhe pjesëmarrjen e publikut në hartimin dhe diskutimin e projektligjeve.

Megjithatë, në shumë raste, legjislacioni liston institucionet përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi, por jo parimet e ushtrimit të këtij detyrimi. Kjo çështje merr rëndësi të veçantë kur në ofrimin e ELP-së ligji ngarkon disa organe të cilat duhet të koordinojnë iniciativat dhe angazhimin e tyre në këtë fushë, midis tyre, iniciativat dhe angazhimin në këtë fushë, si dhe bashkepunimin me organizatat e shoqërisë civile. Përpos mungesës së një kuadri koordinues, në pjesën më të madhe të rasteve, legjislacioni nuk parashikon detyrime specifike për raportimin e ofrimit të ELP-së nga këto institucione, krahas detyrimeve të raportimit vjetor për ushtrimin e funksioneve sipas fushës së përgjegjësisë. Për pasojë, mënyra dhe mekanizmat e përdorur për ofrimin e ELP-së rezultojnë vështirësisht të matshëm.

Vërehen përpjekje të institucioneve për të hartuar dhe vënë në dispozicion të publikut udhëzime, udhërrëfyese ose manuale praktike lidhur me të drejtën e informimit, konsultimin publik apo

zhvillimin e aktiviteteve edukuese të publikut të cilët, thjeshtojnë zbatimin e të drejtës në praktikë të detyrimeve ligjore lidhur me ELP-në.

Një numër i madh dispozitash ligjore parashikojnë detyrime pozitive të administratës publike, qendrore e vendore, lidhur me informimin e edukimin ligjor të publikut. Veçanërisht ligji i ri nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" sanksionon se institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë Ministri i Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe gjykatat. Gjithashtu, punonjësit me trajnim të posaçëm, organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë mund të ofrojnë ndihmë juridike parësore e cila konsiston në i) dhënien e informacionit në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor; ii) dhënien e këshillimit; iii) dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve; iv) dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore; v) përfaqësimin përpara organeve administrative; dhe vi) dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore. Ligji i ri për ndihmën juridike u hartua dhe u miratua si rrjedhojë e problematikave të konstatuara në ofrimin me efektivitet të ndihmës juridike nga organet e ngritura në bazë të ligjit të vjetër (ligji nr.10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike") për shkaqe të organizimit, të kapaciteteve të stafit që u punësua pranë tyre dhe buxheteve të pamjaftueshme që iu vunë në dispozicion, ndër vite. Miratimi i ligjit të ri, në kuadër të reformës në drejtësi, dhe zbatimi i shpejtë i tij janë një faktor i rëndësishëm për ELP.

Tepër i rëndësishëm në drejtim të ELP është edhe ligji nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" që synon garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të respektimit, në praktikë, të lirive dhe të drejtave të individit; lidhur me natyrën dhe situatën e strukturave të shtetit; lidhur me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencave që ju janë dhënë. Për të mundësuar informimin dhe edukimin e publikut, ky ligj parashikon detyrimin e çdo institucioni të administratës publike, në nivel qendror dhe vendor, që të hartojë e publikojë programin e transparencës, që do të mundësojë marrjen e informacionit, pa diskriminim, në afat sa më të shkurtër dhe pa kosto. Këto programe janë hartuar e bërë publike, në përgjithësi, nga institucionet shtetërore, por ka vend të permiresohet puna për publikimin e legjislacionit që rregullon marrëdhëniet në fushat përkatëse të secilit institucion, publikimin e planeve vjetore për procesin vendimarrës (projektligjet që do të hartohen e diskutohen) me qëllim që të mundësohet njoftimi dhe konsultimi publik.

### ***II.5.1.3 Gjetjet nga analiza e kuadrit institucional***

Bazuar në kuadrin institucional të listuar më sipër mund të konkludohet se një pjesë e madhe e institucioneve janë pajisur jo vetëm me detyrimin e informimit të qytetarëve për të drejtat dhe

detyrimet e tyre ligjore dhe veprimtarinë që kryejnë organet e administratës publike, por edhe me ndërmarrjen e hapave konkrete dhe praktike në ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe edukimin e tyre me njohuri ligjore të nevojshme, sipas fushave përkatëse.

Shumë institucione, në kuadër të transparencës dhe të drejtës së informimit, kanë publikuar, ne faqet e tyre elektronike, legjislacionin që qëndron në bazë të veprimtarive që zhvillon institucioni përkatës. Megjithatë, si nga përmbajtja e faqeve zyrtare në internet, ashtu edhe nga informacioni i mbledhur nga institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor, rezulton se pjesa më e madhe e institucioneve mjaftohen me vënien në dispozicion të informacionit për publikun në faqen e internetit. Ato nuk angazhohen në iniciativa të tjera për ta bërë këtë informacion sa më të prekshëm dhe të aksesueshëm për subjektet e interesuara. Për më tepër, shpesh faqet zyrtare të internetit janë të papërditësuara periodikisht me informacionin mbi ndryshimet ligjore, rregullatore, kuadrin institucional të këtyre organeve të administratës publike, si dhe nuk janë interaktive. Një pjesë e institucioneve shtetërore, si ato në nivel qendror edhe vendor, kanë raportuar se nuk ushtrojnë veprimtari të veçanta dhe specifike për të adresuar problemet e edukimit ligjor të publikut, sipas sektorit dhe fushës së përgjegjësisë që ato mbulojnë. Veçanërisht shqetësuese është situata e konstatuar në organet e pushtetit vendor. Duke qenë se këto organe ushtrojnë funksione më afër qytetarëve pritet që të jenë më proaktive në hartimin e programeve ndërgjegjësuere dhe edukative, si dhe në mundësimin e kontaktit të drejtpërdrejtë për të mirinformuar cilindo qytetar brenda juridiksionit të tyre territorial.

Përpos qasjes së kufizuar të ofrimit të shërbimit të ELP-së, është konstatuar një mungesë e koordinimit të ofrimit të shërbimit të ELP-së, si midis organeve të administratës publike, ashtu edhe midis këtyre të fundit dhe organizatave të shoqërisë civile. Si rezultat i mungesës së një qasje të strukturuar në këtë drejtim, mënyra e ofrimit të ELP nga këto organe, ka rezultuar si në mangësi në ofrimin sistematik të këtij shërbimi, ashtu edhe në mbivendosje tematike të ofrimit të shërbimit të ELP-së.

Nga verifikimet e zhvilluara rezulton se vetëm institucioni i Avokatit të Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes (kjo e fundit ka veprimtari vetëm në kuadër të strategjisë për mbrojtjen e konsumatorit), kanë kryer veprimtari për informimin dhe edukimin ligjor të publikut.

Organizimi i “Ditëve të Hapura” nga institucioni i **Avokatit të Popullit**, janë kthyer në një traditë të suksesshme në marrëdhëniet e institucionit me qytetarët, me administratën e pushtetit vendor, drejtuesit e njësisve të qeverisjes vendore, si dhe me përfaqësuesit dhe rrjetin e shoqërisë civile në nivel lokal. Ditët e Hapura janë zhvilluar në një pjesë të bashkive dhe njësisve administrative të vendit. Në takime, qytetarët janë informuar mbi objektin e punës të institucionit si dhe është komunikuar me ta mbi rrugën e ndjekur për zgjidhjen e ankesave. Institucioni i Avokatit të Popullit

funksionon me zyrën e pritjes dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve jo vetëm në Tiranë, por përfaqësohet me zyrat rajonale edhe në shtatë prej qendrave më të mëdha administrative. Fushatat informuese dhe puna në terren e përfaqësuesve rajonalë kanë qenë pjesë e rëndësishme e aktivitetit të përditshëm të punës së tyre. Për periudhën e vitit 2016, në zyrën e pritjes së qytetarëve, zyrat rajonale dhe përmes mjeteve të tjera të komunikimit, atij postar dhe on-line, janë paraqitur 5512 ankesa pranë institucionit të Avokatit të Popullit, nga të cilat 2566 ankesa kanë qenë pjesë e objektit të punës së institucionit të Avokatit të Popullit dhe janë cilësuar “brenda juridiksionit dhe kompetencës” dhe 2946 ankesa janë trajtuar në formën e “këshillimeve dhe orientimeve”, mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të ankesave dhe institucionet që duhet t’u drejtohen. Përveç informacionit të përcjellë nga Faqja Web e institucionit, prej vitit 2012, ky institucion është prezent në Facebook me një profil zyrtar të institucionit si dhe botohet periodikisht një revistë, si një mënyrë e re komunikimi me qytetarët. Ideja e kësaj reviste, siç e dëshmon edhe përmbajtja e saj, nuk është thjesht një botim ku flitet vetëm për institucionin, por është një revistë e të gjithëve, e qytetarëve dhe për qytetarët, e punonjësve të Administratës Publike dhe për punonjësit e Administratës Publike, e shoqërisë civile dhe për shoqërinë civile<sup>65</sup>.

Në raportin e vitin 2016 të **Komisionerit për mbrojtjen nga Diskriminimi** citohet se KMD i ka kushtuar një vëmendje të veçantë nxitjes së parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke shfrytëzuar disa instrumente, me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe rritjen e identifikimit të rasteve apo ankesave<sup>66</sup>. Kontributi i punonjësve të KMD në median e shkruar dhe elektronike, organizimi i workshop-eve, tryezave, seminareve dhe konferencave, organizimi i Ditëve të Hapura, forcimi i bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse, institucione të pushtetit qendror dhe vendor, universitetet dhe aktorë të tjerë, i ka krijuar më shumë mundësi institucionit të KMD-së të ndërgjegjësojë publikun në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin. Gjithashtu, përmes organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese është rritur niveli i informacionit të publikut mbi mjetet ligjore, rolin e KMD, gjykatës. Gjithashtu, KMD i ka është kushtuar vëmendje shpërndarjes së botimeve të ndryshme, me qëllim rritjen e informacionit të komunitetit mbi situatat diskriminuese dhe mjetet që mund të përdoren për adresimin e tyre. Faqja zyrtare e institucionit është rikonceptuar me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve dhe sigurimin e një komunikimi të vazhdueshëm të institucionit me ta.

Veprimtaria e **Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjen e të Dhënave Personale** është tepër i rëndësishëm për të garantuar zbatimin korrekt të ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Duke iu referuar raportit të paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë nga ky institucion, gjatë vitit 2017<sup>67</sup>, rezulton se ka përmirësime të ndjeshme në këtë drejtim. Janë kryer 83 inspektime nga Zyra e Komisionerit lidhur me respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Janë monitoruar programet e transparencës, në mënyrë të veçantë i atyre të organeve të qeverisjes vendore. Janë trajtuar 560 kërkesa dhe ankesa që pretendonin cenimin e të

<sup>65</sup> [http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RAPORTET/RAPORTET\\_VJETORE/Raporti\\_2016.pdf](http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RAPORTET/RAPORTET_VJETORE/Raporti_2016.pdf)

<sup>66</sup> <http://kmd.al/skedaret/1509612773-KMD%202016.pdf>

<sup>67</sup> [http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/RAPORTI\\_VJETOR\\_2017.pdf](http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/RAPORTI_VJETOR_2017.pdf)

drejtës së informimit. Janë zhvilluar veprimtari për ndërjegjësimin e studentëve, stafit akademik, sistemit gjyqësor, organet e rendit, medias, si dhe për publikun e gjerë. Është realizuar kualifikimi i thelluar i kapaciteteve institucionale, nëpërmjet trajnimeve me ekspertë ndërkombëtare dhe sesion pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Tepër të rëndësishme janë gjetjet e veprimtarisë monitoruese të Komisionerit, nga e cila ka rezultuar se vetëm 181 Autoritete Publike (nga 429 në total) kanë miratuar dhe bërë publik programin e transparences; vetëm 227 autoritete publike kanë caktuar Koordinator për të drejtën e informimit; vetëm 124 Autoritete Publike kanë krijuar dhe publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve<sup>68</sup>.

Siç e theksuam më sipër, **Ministria e Drejtësisë** kujdeset dhe mbështet veprimtaritë shkencore në fushën e drejtësisë dhe përhapjen e edukatës juridike, si dhe kujdeset për ndjekjen dhe bashkërendimin e marrëdhënieve me shoqërinë civile për fushën e drejtësisë. Pranë kësaj ministrie veprojnë dy qendra informimi ligjor përkatësisht, qendra për viktimat dhe klinika e ligjit. Kjo e fundit synon të kryejë disa funksione si orientimin e qytetarit për identifikimin e saktë të problemit, institucionit që duhet t'i drejtohet dhe formës nëpërmjet së cilës duhet të kërkojë shërbimin; asistimin në hartimin e shkresave dhe kërkesave sipas nevojës së qytetarit lidhur me ankesat me shkrim në marrëdhënie me administratën publike dhe gjyqësore; dhënien e informacionit parësor mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë qytetarët; këshillimin ligjor mbi ndihmën juridike falas dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim etj.

Materiale të karakterit edukues dhe informues për qytetarët apo kategori të ndryshme të personave në nevojë janë botuar me punën e organizatave të shoqërisë civile apo me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare në vend ndaj institucioneve përkatëse. Megjithatë, mungon një bazë të dhënash e plotë dhe e konsoliduar e të gjitha këtyre botimeve edukuese dhe informuese.

Siç u theksua më sipër, nga veprimtaria monitoruese e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë vitit 2017, rezulton se vetëm 181 Autoritete Publike (nga 429 në total) kanë miratuar dhe bërë publik programin e transparences; vetëm 227 autoritete publike kanë caktuar Koordinator për të drejtën e informimit; vetëm 124 Autoritete Publike kanë krijuar dhe publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Për të bërë realitet të drejtën e qytetarëve për informim e edukim, duhet avancuar me shpejtësi për miratimin e programeve të transparencës nga të gjitha institucionet e detyruara, sipas ligjit, caktimin e kordinatorëve për të drejtën e informimit, krijimin dhe publikimin prej tyre të regjistrate të kërkesave dhe përgjigjeve. Në mënyrë të veçantë ka nevojë që subjektet e parashikuara në ligj të përmirësojnë pasqyrimin e informacionit që ofrojnë në faqet e tyre zyrtare në internet, ta pasurojnë dhe azhurnojnë atë në vazhdimësi, veçanërisht në lidhje me situatën e legjislacionit të fushës ku vepron subjekti përkatës.

Ligji nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe

---

<sup>68</sup> Po aty fq. 5



vendimmarrëse të organeve publike. Nga një analizë e praktikave të punës së Këshillit të Ministrave dhe 19 ministrive<sup>69</sup>, janë evidentuar disa problematika, lidhur me zbatimin e këtij ligji, veçanërisht me transparencën e veprimtarisë ligjvënëse të këtyre organeve dhe mundësimin e përfshirjes së publikut të interesuar në këtë proces. Më konkretisht,

- shumica e ministrive nuk kanë publikuar planet vjetore që lidhen me procesin e vendimmarrjes për vitin 2015-2016, sikurse ligji e kërkon.
- gjatë viteve 2015 – 2016, rreth 240 projekt-akte janë konsultuar me grupe interesi, por shpesh konsultimi ka patur karakter formal. Grupeve të interesit të përfshira në konsultim nuk ju është dhënë koha e duhur për të studiuar projekt-aktet dhe për përgatitjen e vërejtjeve dhe sugjerimeve përkatëse.
- nga grupet e interesit ka pretendime se përzgjedhja e subjekteve për konsultim bëhet mbi baza selektive dhe të njëanshme duke cenuar parimin e gjithëpërfshirjes dhe ofrimit të shanseve të barabarta.
- nga monitorimi rezulton se ka mungesë transparence në drejtim të informimit të grupeve të interesit, të përfshira në konsultim, lidhur me shkaqet e mos marrjes në konsideratë të vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre, si dhe për numrin e takimeve publike të organizuara.

Mekanizmat e Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare të ngritura në 37 bashki të vendit mbështesin informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuëse për dhunën; referuar në VKM nr.334, datë 17.2.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”. Forma të informimit të përdorura prej Mekanizmave të Referimit janë edhe edukimi ligjor dhe informimi nga ekipi teknik, informimi në shkollë, në njësitë administrative, etj. Mbështetja e njësive të qeverisjes vendore në lidhje me këtë komponent ka nevojë të forcohet.

Nga monitorimet e kryera në terren, prej shoqërisë civile<sup>70</sup> dhe organizatave ndërkombëtare<sup>71</sup> dhe nga problematikat që manifestohen gjatë shqyrtimit administrativ e gjyqësor të kërkesave/ankesave, të adresuara nga individë të ndryshëm, rezulton se njohuritë e tyre rreth legjislacionit në fuqi janë shumë të pakta. Sipas një studimi të UNDP, të vitit 2017, mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri, konsatohet se *“individët kanë nivel mjaft të ulët njohurie për të drejtat e tyre: më shumë se një e katërta e personave të anketuar nuk ishin në gjendje të përmendnin emrin e asnjë prej të drejtave*

<sup>69</sup> Monitorim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit mbi zbatimin e ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, në Prill 2017, <http://www.ahc.org.al/projects/>

<sup>70</sup> Raport Monitorimi Rajonal, faqe 49, 53, 66, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2016; Raport “Mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria”, faqe 20, 40, 54,62 Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2016 ; Raport “Mbi ofrimin e ndihmes juridike shtetërore në Shqipëri”, faqe 5, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, 2012.

<sup>71</sup> Studim mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri, UNDP, 2017, fq 7, <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/survey-on-access-to-justice-in-albania.html>

dhe lirive kushtetuese. Po kështu, ka mangësi njohurish për sa i përket të drejtave të grave, si dhe të drejtave të personave LGBTI dhe grupeve të tjera të pafavorizuara. Për shembull, pak më shumë se një e treta e personave të anketuar janë të mendimit se një grua e martuar që ka marrë pajë nuk ka të drejtë trashëgimie nga prindërit e saj pas martesë. Niveli i ulët i njohjes dhe njohurive ligjore është më i theksuar në radhët e popullatës rome, personat me nivel arsimor të ulët, dhe nivel të ardhurash më të ulëta”. Gjendja paraqitet më e përkeqësuar në komunitetet në nevojë, të cilët përveç mungesës së njohurive rreth legjislationit, nuk kanë as mundësi ekonomike për të angazhuar një avokat që do t’iu shpjegojë e mbrojë çështjet e tyre ligjore.

Për të gjitha arsyet e sipërpërmendura, por jo vetëm, është e qartë që praktika e deritanishme e punës, që kufizohet vetëm në publikimin e legjislationit, duke prezumuar se kjo mjafton për tu njohur menjëherë nga i gjithë publiku, duhet ndryshuar. Ndihet nevoja që institucionet publike, sistemi arsimor dhe shoqëria civile të ndërmarrin nisma konkrete e të vazhdueshme në këtë drejtim, mbi bazë të planeve dhe akteve të mirëpërcaktuara.

### **II.5.2 Fushat prioritare të edukimit ligjor të publikut**

Duke pranuar se është pozitive, në shumë pikëpamje, që individët të njohin legjislationin në fuqi, natyrshëm shtrohet pyetja se cili është kuadri ligjor, që përbën përparësi, në këtë drejtim. Informimi dhe edukimi ligjor i qytetarëve duhet të jetë i vazhdueshëm dhe në përputhje me nevojat e gjithësecilit. Në të gjitha format e saj një parim i rëndësishëm për edukimin ligjor është edhe gjuha e përdorur. Duke marrë parasysh faktin që edukimi ligjor i drejtohet publikut, i përbërë nga shtresa të ndryshme është e rëndësishme që gjuha e përdorur në dhënien e informacionit të jetë sa më e thjeshtë dhe e kuptueshme. Një arsye se përse shpesh herë ligji mbetet një instrument i vështirë për qytetarët e thjeshtë është pikërisht përdorimi i një gjuhe të vështirë dhe teknike, si dhe formulimi i tekstit.

Pavarësisht nevojave specifike të grupeve të ndryshëm të individëve, një numër dispozitash ligjore janë të interesit të përgjithshëm, sepse trajtojnë të drejta e detyrime bazike e gjithëpërfshirëse. Këtu përfshihet, së pari, **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, veçanërisht paketa e saj, që sanksionon liritë dhe të drejtat themelore, si dhe kapitujt që sanksionojnë shtrukturat e pushtetit shtetëror dhe organet kushtetuese, si dhe kompetencat e tyre. Duke u njohur me ligjin themelor të shtetit, shtetasit shqiptarë, por dhe të huajt rezidentë në vendin tonë, ndërgjegjësohen rreth sistemit qeverisës në Republikën e Shqipërisë, njohin natyrën e pushteteve, ndërveprimin midis tyre dhe kompetencat që ju janë përcaktuar. Është tepër e rëndësishme që publiku të njihet me liritë dhe të drejtat e tyre, gjë që do t’i motivojë për t’i mbrojtur ato dhe për të kërkuar respektimin e tyre nga kushdo që tenton t’i cenojë ato.

**Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore, të miratuara në kuadër të Reformës në drejtësi**, kanë përmirësuar dhe garantuar një shqyrtim deri në nivelet më të larta të çdo pretendimi për cenim të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe kjo i bën më të interesuar individët t’i njohin të drejtat që u

sanksionon Kushtetuta dhe të veprojnë për mbrojtjen e tyre, por për këtë ata kanë nevojë të njihen me rregullimet e reja ligjore që ka ndërmarrë Kuvendi i Shqipërisë.

**Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”** është, gjithashtu, me interes të njihet nga individët, sepse është ky pushtet që trajton nevojat e përditshme të tyre. Njohja e këtij ligji do t'i motivojë më shumë ata për të mbikëqyrur dhe bashkëvepruar me këtë pushtet, për çështjet e interesit komunitar dhe për respektimin gjithnjë e më të mirë të lirive dhe të drejtave të njeriut nga këto organe.

**Ligje të tjera** të kësaj rëndësie për tu njohur nga individët janë Kodi i Punës, Kodi i Familjes, Ligji nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Ligji nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ligji nr.7703, date 11.4.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” etj. Këto janë dispozita ligjore që rregullojnë marrëdhënie në të cilat të gjithë qytetarët mund të jenë të përfshirë gjatë jetës së tyre. Disa nga këto dispozita rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të pavarura publike, të cilat janë krijuar për të vepruar në ndihmë të individëve për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tyre, kryesisht nga administrata publike. Të tillë përmendim ligjin “Për Avokatin e Popullit”, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ligjin “Për të drejtën e informimit”.

Njohja nga individët e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, pavarësisht punës së mirë që është bërë në këtë fushë, mbetet me interes të punohet me publikun në vazhdimësi, sepse komuniteti dhe vetë fenomeni i dhunës ndryshon ndër vite. Njohja me këtë ligj është me interes për parandalimin e fenomenit, për të nxitur individët që të denoncojnë çdo manifestim të kësaj dhune dhe për t'i bërë ata aktivë e bashkëveprues për luftimin e sjelljeve të tilla. Ligji ka vend të njihet më mirë dhe nga punonjësit e strukturave përgjegjëse, të ngarkuar me detyra specifike nga ligji në fjalë, sepse me gjithë përmirësimet, ende konstatohen mangësi në kryerjen e këtyre detyrave nga strukturat përgjegjëse. Gjithashtu, konsiderohet i nevojshëm zgjerimi i njohurive edhe për legjislacionin kundër të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës me bazë gjinore, për të cilat ka shumë pak njohuri, si dhuna seksuale, përndjekja, martesat e detyruara etj, të parashikuara si vepra penale në legjislacionin penal. Detyrimi për informimin e publikut mbi legjislacionin që trajton të gjitha format e dhunës ndaj grave rrjedh nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

Në lidhje me ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, individët mund të kenë interes të njihen me rrugët e mjetet për t'u organizuar e aktivizuar në komunitet dhe për të luajtur më mirë rolin e tyre në shoqërinë demokratike. Njohja e këtij ligji do të mundësojë dhe një kuptim më të mirë të rolit dhe veprimtarisë së këtyre organizatave në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të

njeriut, në mbështetjen e grupeve në nevojë dhe për presionin që ato ushtrojnë ndaj strukturave publike për plotësimin e nevojave të komunitetit e grupeve të veçanta me nevoja të ndryshme.

Gjithashtu çdo individ i rritur duhet të njohë bazat e përgjegjësisë penale; të drejtat dhe përgjegjësitë civile; të ketë njohuri rreth kontratave dhe mënyrës së shlyerjes së detyrimeve. Të gjithë duhet të kenë akses në informacionin bazë për legjislacionin mbi të drejtën e pronësisë dhe mbi qiramarrjen e shitblerjen e pasurive të paluajtshme, sepse këto janë marrëdhëniet më të shpeshta në të cilat individët mund të përfshihen në jetën e tyre.

Banorët e zonave informale përballen me zhvillim social dhe përparim të ngadaltë. Duke qenë se shqetësimi kryesor i grupit në fjalë lidhet me procesin e legalizimit të banesave, shfaqet i nevojshëm marrja e informacionit rreth procesit të legalizimit, integritimit mjedisor, urbanizimit. Po kështu, rritja e njohurive të banorëve rreth ligjeve në tërësi do të ndikojë drejtëpërdrejtë në rritjen e integritimit social të tyre.

Lista e ligjeve dhe instituteve ligjore të shënuara më sipër nuk është shteruese, por tenton të sjellë në vëmendje nevojat e larmishme të individëve për të njohur legjislacionin që rregullon marrëdhënet shoqërore ku ata përfshihen gjatë jetës së tyre. Kjo nuk përbën detyrim të tyre për të përvetësuar njohuritë e lart përmendura, por për një detyrim të administratës publike, qendrore dhe lokale, të cilat, qoftë dhe në bashkëpunim me OSHC-të, do të duhet të ofrojnë të gjitha mundësitë në këtë drejtim. Për këtë duhen programuar, organizuar e zbatuar veprimtari informuese e edukuese për publikun mbi legjislacionin e fushës ku këto institucione e organizata veprojnë dhe janë kompetentë. Kjo Strategji i shërben këtij qëllimi.

### ***II.5.3 Edukimi ligjor i publikut në përputhje me nevojat e grupeve të veçanta të individëve***

Përveç sa më sipër, që janë ligje në interes të të gjithë individëve, në shoqëri ka shtresa shoqërore, ose grupe personash me nevoja të ndryshme, që lidhen me moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore ose rrethana të tjera jetësore të tyre. Për këtë arsye ata kanë nevojë të domosdoshme të njihen me ligje specifike që trajtojnë problematikat e tyre dhe parashikojnë mjetet e rrugët për zgjidhje ose plotësimin e nevojave specifike të këtyre komuniteteve dhe individëve.

***Të rinjtë, vajza dhe djem (mbi 18 vjeç)***- kanë nevojë për formim dhe zgjerim të mëtejshëm të njohurive juridike, informim rreth legjislacionit si: Kushtetuta e Shqipërisë, ligji për arsimin e lartë, ligji për konsultimin publik, politikat dhe legjislacioni për vullnetarizmin, marrëdhëniet e punës, ligji për ndihmën juridike, kuadri ligjor kundër dhunës në familje, programet aktuale të punësimit në Shqipëri. Gjithashtu, ata duhet të informohen për masat e nevojshme që parandalojnë përfshirjen e tyre në grupe të ekstremizmit të dhunshëm.

***Të miturit***- informimi rreth legjislacionit fillon që në bankat e shkollës, në përshtatje me moshën e kapacitetet e fëmijëve. Përveç njohurive rreth mënyrës së organizimit e funksionimit të strukturave të pushtetit shtetëror e organeve kushtetuese dhe ligje të tjera që do të trajtohen në përputhje me

moshën e programet mësimore, është me shumë rëndësi që fëmijët të njihen me ligjet specifike që trajtojnë të drejtat e fëmijës si ligji "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" dhe konventat e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë në këtë fushë. Gjithashtu, është i nevojshëm informimi mbi mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e të drejtave të fëmijëve. Ata duhet të njihen me të drejtat, por dhe me detyrimet e tyre me qëllim që të ndërgjegjësohen se janë subjekte të së drejtës, njësoj si të rriturit. Krahas kësaj, nxënësit e shkollave të mesme duhet të marrin njohuri dhe për atë pjesë të legjislacionit që i përgatit ata për daljen në jetë, si persona madhorë, me zotësi juridike të plotë. Çdo nxënës duhet të përfundojë studimet e shkollës së mesme me njohuri të mjaftueshme mbi organizimin e funksionimin e shtetit, mbi të drejtat e detyrimet si shtetas, me njohuri mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, njohuri mbi të drejtën familjare, përgjegjësitë juridiko-civile, marrëdhëniet kontraktore më të zakonshme, marrëdhëniet e punës e sigurimet shoqërore, njohuri mbi përgjegjësinë penale dhe informacione në fusha të tjera. Gjithashtu, edhe ata duhet të informohen për masat e nevojshme që parandalojnë përfshirjen e tyre në grupe të ekstremizmit të dhunshëm.

***Vajzat dhe gratë nga zonat rurale dhe grupet e pafavorizuara***<sup>72</sup>, vazhdojnë të konsiderohen si grup vulnerabël pasi shpesh në shoqërinë shqiptare janë subjekt i fenomeneve negative të tilla si: martesat në moshë të vogël, martesat e detyruara, shtatëzania e padëshiruar, ndërprerja e procesit arsimor, trafikimi, dhuna në familje, diskriminimi në tregun e punës, pabarazia gjinore në vendimmarrje, mungesa e aksesit në të drejtat pronësore, legjislacioni i punës etj. Për këto arsye, duhet të punohet për informimin e edukimin e tyre, veçanërisht në zonat rurale, rreth parashikimeve në legjislacion për çështjet e lartpërmendura. Gratë dhe gjithë shoqëria do të ndërgjegjësohen se respektimi i barazisë gjinore është jo vetëm e garantuar me norma ligjore, por dhe interes e objektiv i të gjithë shoqërisë. Janë me interes për këtë komunitet dhe legjislacioni që trajton të drejtat e grave në marrëdhëniet familjare, veçanërisht të drejtat e tyre ekonomike e pasurore, si dhe mbrojtja nga dhuna në marrëdhëniet familjare, dy fusha ku rezultojnë të këte ende jo vetëm shkelje e dhunim të të drejtave, por dhe njohje të pakët të legjislacionit.

### ***Personat në kushte të veçanta***

***Personat me aftësi të kufizuara***- përballen çdo ditë me sfida për trajtimin, rehabilitimin dhe integrimin e tyre në shoqëri. Megjithëse, në vitet e fundit kuadri ligjor dhe ndjeshmëria e shoqërisë ndaj personave me aftësi të kufizuara është përmirësuar, kjo kategori është në një pozitë të disfavorizuar në krahasim me pjesën tjetër të shoqërisë. Vulnerabiliteti i tyre duhet balancuar me një punë të madhe për fuqizimin e tyre në drejtim të rritjes së njohurive mbi legjislacionin që u sanksionon të drejtat dhe që përcakton mjetet dhe procedurën për përfitimimin e këtyre të drejtave. Për shkak të aftësive të kufizuara, kjo kategori personash ka nevojë edhe për rrugë specifike për tu

<sup>72</sup> Të identifikuar nga Komiteti i Konventës së OKB-së mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) në Vëzhgimet Përfundimtare drejtuar Shqipërisë (2016): "gratë rurale dhe grupet e pafavorizuara të grave - gratë më të moshuara, gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara, gratë migrante, gratë lezbike, biseksuale dhe transjinore, gratë në paraburgim, gratë e izoluar dhe gratë që kërkojnë azil "(para.39).

edukuar e informuar mbi legjislacionin që i intereson. Për të forcuar pozitat e këtij grupi, për ta duhet të sigurohet informacion i detajuar rreth të drejtave të tyre për edukim, punësim, shërbime shëndetësore dhe rehabilituese, etj. duke i kushtuar vëmendje të veçantë mosdiskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar (parashikuar në Kushtetutë e ligje të tjera).

**Viktimat e trafikimit-** mund të denoncojnë trafikantin/grupin e trafikantëve ose jo, por në çdo rast është i nevojshëm informimi i tyre rreth legjislacionit penal mbi trafikimin njerëzor (dënimet e parashikuara për trafikantët), rreth ligjit nr.10 173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, mbi mundësitë ligjore për kompensimin e viktimave të trafikimit, mënyrat alternative për dhënien e dëshmisë në gjykatë, mbi mundësitë për të përfituar ndihmën juridike, legjislacionin për përfitimin e ndihmës ekonomike, Kodin e Procedurës Penale, koordinatorin dhe rolin e tij, organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime, legjislacionin civil që parashikon kërkimin e dëmit, etj. Nisur nga fakti se reforma në drejtësi po ndikon në mënyrë të rëndësishme në çështjen e trafikimit njerëzor, paraqitet i domosdoshëm informimi i grupit në fjalë rreth ndryshimeve ligjore në këtë fushë.

**Viktimat e dhunës në familje-** duhet të informohen kryesisht për Konventën e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje, ratifikuar me ligjin nr.104/2012 (njohur ndryshe si Konventa e Stambollit), parashikimet në Kodin Penal rreth dhunës në familje, ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Familjes, Ligjin nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, dhe , legjislacionin për ndihmën juridike, për përfitimin e ndihmës ekonomike, legjislacionin mbi programet sociale të strehimit, organizatat që kanë ngritur klinika ligjore dhe ofrojnë shërbime ligjore falas dhe shërbime të tjera, si ai psikologjik, punësim, programe rehabilitimi etj. Në mënyrë që të sigurohet mbrojtje efektive e viktimave të dhunës në familje është mjaft e rëndësishme njohja e tyre me Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, institucionet pjesë e tij dhe mbështetja konkrete që secili institucion ofron për viktimat.

**Komuniteti rom dhe egjiptian-** kryesisht përballet me probleme të integritimit në shoqëri. Në këtë kuadër, nevojitet shpërndarja e informacionit rreth legjislacionit në fushën e arsimimit, kujdesit shëndetësor, punësimit, formimit profesional, strehimit, përfitimit të ndihmës ekonomike, integritimit urban dhe mbrojtjes sociale, si edhe mbrojtjes nga diskriminimi. Rëndësi të veçantë ka njohja e këtij grupi me Planin Kombëtar të Veprimit për Integritimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020.

**LGBT-** komuniteti LGBT përfshin të gjithë personat me orientim të ndryshëm seksual përfshirë këtu personat lezbikë, gejt, biseksualë, transgjjinorë, interseks dhe *queer*. Grupimi i tyre në një komunitet më vete ka të bëjë vetëm me nevojën për adresimin e disa çështjeve që kanë në fokus mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të këtij komuniteti. Komuniteti LGBT ka nevojë të vazhdueshme për edukim ligjor dhe për mbrojtje në fusha të tilla si mosdiskriminimi, e drejta për

azil dhe emigracion, e drejta familjare, arsimimi, edukimi, punësimi dhe sigurimi i të mirave dhe shërbimeve.

**Personat me liri të kufizuar**- informimi dhe edukimi ligjor i personave me liri të kufizuar duhet të jetë pjesë e programeve rehabilituese për ta, por në të njëjtën kohë mbetet me rëndësi që ata të njihen me legjislacionin që rregullon të drejtat e detyrimet e tyre si persona me liri të kufizuar, duke përfshirë ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, pa përjashtuar këtu dhe Kodin Penal e Kodin e Procedurës Penale dhe ligje të tjera që i shërbejnë rehabilitimit të tyre. Në veçanti të miturve dhe grave që u është kufizuar liria kanë nevojë të veçanta për shkak edhe të specifikave të moshës e gjinisë dhe këto elementë do të merren në konsideratë për edukimin ligjor të tyre.

**Punëkërkuesit** - me termin “punëkërkues” sipas legjislacionit shqiptar nënkuptohet çdo person i papunë, i disponueshem për punësim, i cili paraqitet periodikisht në zyrën përkatëse të punësimit. Edukimi ligjor i kësaj kategorie personash duhet të përfshijë informimin e tyre për politikën e punësimit dhe mundësitë që ofron tregu i punës, formimin e tyre profesional, këshillim për orientim profesional, informim për vendet e lira të punës, ndërmjetësim për punësim etj.

**Azilkërkuesit ose personat e huaj në Shqipëri** - azilkërkues është një person, i cili kalon kufijtë ndërkombëtarë për shkak të frikës nga persekutimi. Përkufizohet kështu, për sa kohë që nuk ka marrë ende përgjigje apo vendimin mbi kërkesën e tij për të përfituar statusin e refugjatit. Personat e huaj rezidentë në vendin tonë, ose ata që janë azilkërkues, kanë të drejtë të njihen me legjislacionin që rregullon statusin e tyre. Në mënyrë të veçantë azilkërkuesit i duhet dhënë gjithë informacioni i nevojshëm ligjor, me qëllim që t’u sigurohet akses i nevojshëm, në përputhje me ligjin, për të adresuar kërkesat dhe ankesat përkatëse. Për shkak të situatës së tyre, azilkërkuesit kanë nevojë të informohen për të drejtat e tyre dhe për çështje që kanë të bëjnë me: migrimin, hyrjen në mënyrë të paligjshme, dëbimin, deportimin, strehimin, riatdhesimin, fitimin e shtetësisë, kthimin në vendin e origjinës, paisjen me dokument identiteti, punësimin etj. Kushtetuta jonë u garanton shtetasve të huaj dhe atyre pa shtetësi në territorin e vendit respektimin e të gjitha lirive dhe të drejtave që u njihen shtetasve shqiptarë, përveç rasteve të veçanta kur Kushtetuta dhe ligje të posaçme parashikojnë ndryshe.

**Të kthyerit** - përfshin kategorinë e emigrantëve shqiptarë të kthyer nga emigrimi për arsye të ndryshme. Shumica e tyre kthehen për shkak të pamundësisë për të patur një qëndrim të ligjshëm në vendet ku kanë emigruar apo edhe për faktorë të tjerë, si mungesa e punësimit apo për arsye familjare. Problemi më i madh i të kthyerëve është se në momentin e kthimit janë në një situatë shumë të vështirë ekonomike dhe sociale dhe kanë nevojë për tu informuar për të drejtat dhe mundësitë që ata kanë për t’u riintegruar në shoqëri. Disa nga çështjet për të cilat ata kanë nevojë për edukim dhe informim ligjor kanë të bëjnë me strehimin, arsimimin, punësimin, njohjen e viteve

të punës dhe kontributeve për efekt sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore, për të aplikuar për shërbime të ndryshme, plotësim dokumentacioni etj.

**Shtresat në nevojë** (pamundësi ekonomike) – në kategori personash përfshihen të gjithë ata individë apo grupe individësh të cilët për shkak të disa karakteristikave që lidhen me vulnerabilitetin e tyre kanë nevojë për trajtim dhe ndihmë të vazhdueshme, në veçanti për edukim dhe informim ligjor. Ky kategorizim i referohet kryesisht pamundësisë së tyre ekonomike dhe vulnerabilitetit në tregun e punës. Këtu përfshihen të varfërit individë të paarsimuar ose me nivel arsimor bazë, të papunët, të vetëpunësuarit ose punëtorët e fermave familjare në bujqësi, personat në zonat rurale që nuk kanë tokë ose kanë shumë pak tokë, gratë vulnerabël (në nevojë) dhe fëmijët, anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara etj. Në varësi të grupit dhe karakteristikave të vulnerabilitetit duhet orientuar edhe edukimi i tyre ligjor, si dhe adresimi i nevojave. Këto shtresa kanë nevojë të informohen për të drejtat e tyre ligjore dhe mundësitë që ata kanë për të përfutur nga programet e ndihmës ekonomike e ligjore. Edukimi i tyre ligjor duhet të përfshijë çështje që kanë të bëjnë me nevojat dhe fuqizimin e tyre në disa drejtime si: përmbushjen e nevojave bazë për një jetesë normale, arsimimin, familjen, punësimin, ndihmën shëndetësore, mosdiskriminimin, si mund t'u drejtohen gjykatës, etj.

**Bizneset** – në këtë kategori përfshihen të gjithë personat fizikë dhe juridikë të cilat ushtrojnë një veprimtari në fushën e biznesit. Në veçanti bizneset e vogla, sipërmarrësit, të vetëpunësuarit kanë mungesë të theksuar të njohurive për kushtet që duhet të plotësojnë për hapjen e një biznesi, por edhe për ecurinë e tij sidomos kur përballen me kontrollet dhe detyrimet tatimore. Legjislacioni dhe aktet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e biznesit janë kontradiktore dhe jo transparente. Ndryshimet e shpeshta dhe mungesa e informacionit apo marrja me vonesë e tij ka sjellë jo vetëm problemin e mosrespektimit të legjislacionit nga ana e bizneseve, por edhe probleme në marrëdhëniet jokorrekte midis bizneseve dhe punonjësve të administratës tatimore, duke favorizuar mundësitë për mitmarrje dhe korrupsion. Bizneset e vogla nuk kanë as kapacitete për të përballuar shërbimet dhe konsulentat ligjore dhe për këtë arsye kjo kategori ka nevojë për një paketë shërbimesh edukimi dhe informimi ligjor duke e thjeshtuar edhe mënyrën e komunikimit dhe duke ndërtuar mekanizma praktik të informimit të tyre.

### KAPITULLI III. VIZIONI DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

SELP, përcakton vizionin, qëllimet dhe objektivat strategjike të edukimit ligjor përgjatë periudhës 2018-2023. SELP përputhet plotësisht me dokumentat strategjikë në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është prioritet i Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të procesit të anëtarësimit janë nënshkruar dokumenta që parashikojnë detyrimet që merr përsipër vendi ynë.



**MSA BE–Shqipëri** u nënshkrua më 12 qershor 2006 dhe hyri në fuqi më 1 prill 2009. Në MSA përcaktohet angazhimi i Republikës së Shqipërisë në forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Në aktet politike dhe strategjike është konkretizuar arritja e këtij synimi. Ndër masat që do të merren është edhe hartimi i Strategjisë “Për edukimin ligjor të publikut”. Kjo strategji parashikohet si pjesë e paketës ligjore që synon forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në dokumenta kombëtarë.

**Deklarata e Parimeve udhëheqëse të zhvillimit të qëndrueshëm**<sup>73</sup> të Komisionit Evropian, midis parimeve të shumta të përfshira të qëndrueshmëria, një theks të veçantë i jep *zhvillimit njerëzor dhe kohezionit social*, ku qytetarët janë në qendër të zhvillimit në një shoqëri të lirë, demokratike, shoqërisht përfshirëse, kohezive, të shëndetshme, të sigurtë dhe të drejtë, që respekton të drejtat themelore të njeriut dhe të drejtat qytetare, dhe që hedh poshtë të gjitha format e diskriminimit; si dhe *informacionit dhe njohurive* që përdoren si një faktor zhvillimi, si bazë për vendimmarrje të mbështetur në evidenca. SELP kontribuon në përmbushjen e tyre.

**Kuvendi**, me Vendimin nr.96/201474 ngriti Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Komisioni i Posaçëm ka patur, ndër të tjera, për objekt të veprimtarisë së tij edhe *“Hartimin e një dokumenti strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, bazuar në analizën e gjendjes aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë*<sup>75</sup>”. Në vijim të Analizës<sup>76</sup>, u hartua Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe Plani i Veprimit përkatës<sup>77</sup>. Këto dokumente<sup>78</sup> shërbyen si bazë për hartimin e ndryshimeve kushtetuese, si dhe paketës së projektligjeve që do të bëjë të mundur zbatimin e reformës në drejtësi. Në Strategjinë e Reformës në Sistemin e Drejtësisë<sup>79</sup> parashikohet *“Edukimin ligjor dhe arsimit juridik”* si një nga 7 shtyllat bazë të reformës në sistemin e drejtësisë. Në datë 16 dhjetor 2016, u prezantua në Komisionin e Posaçëm Parlamentar paketa prej 27 projektligjesh hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë së bashku me ekspertët ndërkombëtarë të EURALIUS, OPDAT dhe OSBE. Kjo paketë e përbërë nga 27 projektligje, do t’i shërbejë implementimit të plotë të reformës në drejtësi në këndvështrimin procedural dhe teknik. Pjesë e paketës së projektligjeve është edhe Strategjia e Edukimit Ligjor të Publikut në Republikën e Shqipërisë.

73 SZHKI, fq.34

74 [https://www.parlament.al/www-content/uploads/2015/10/vendim\\_nr\\_96\\_dt\\_27\\_11\\_2014\\_20207\\_1.pdf](https://www.parlament.al/www-content/uploads/2015/10/vendim_nr_96_dt_27_11_2014_20207_1.pdf)

75 Për realizimin e detyrave të sipërpërmendura, pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar u ngrit Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i mbështetur nga një sekretariat teknik. Në përfundim të Analizës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe mbështetur mbi gjetjet e saj, u hartua nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë me asistencën e Sekretariatit Teknik, Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë dhe PV për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

76 Miratuar nga Kuvendi me vendimin nr.14, dt.30.07.201576 “Për miratimin e Dokumentit ‘Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri’”

77 Miratuar me vendimin nr.15, datë 30.07.2015 “Për miratimin në parim të Strategjisë dhe PV për reformën e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”

78 <http://reformenadrejtesi.al/vendime>

79 [https://reformenadrejtesi.al/sites/default/files/draft\\_strategjia\\_versioni\\_shqip.pdf](https://reformenadrejtesi.al/sites/default/files/draft_strategjia_versioni_shqip.pdf) fq.4.

**Këshilli i Ministrave** me VKM nr. 42, datë 25.1.2017 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Integritit Evropian 2017-2020”<sup>80</sup>, i cili hartohet dhe miratohet në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në pjesën “*Kriteret politike dhe ekonomike, Demokracia dhe shteti i së drejtës*”, ka parashikuar se do të hartohet projektstrategjia “Për edukimin ligjor të publikut” në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë. Kjo Strategji do të jetë pjesë e paketës së 26 projektakteve: 25 projektligje dhe 1 projektstrategji, të cilat do të hartohen nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë që funksionon pranë Komisioni të Posaçëm Parlamentar. Në SKZHI 2015-2020<sup>81</sup>, në shtyllën 3 “Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezioni social” përcaktohet mundësia i një sistemi më të fortë të mbrojtjes sociale dhe sigurimi i përfshirjes sociale, ku shoqëria u mundëson shqiptarëve qasje të barabartë. Ndërgjegjësimi për mjetet ligjore të disponueshme dhe sigurimi më i madh i të drejtës për informim konsiderohen sfida të SZHKI-së. Prioritetet strategjike të përcaktuara në këtë dokument zhvillohen me gjerë, në dokumente të tjera në nivel kombëtar, si pjesë e shtyllës së tretë të SKZHI 2015-2020 “Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezioni social”.

Mbështetur në objektivat e dokumenteve strategjike të sipërpërmendur në të cilët mbështetet hartimi i SELP, vizioni i ELP-së për vitet e ardhshme është:

*Qytetarë më të ndërgjegjësuar për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.*

SELP synon organizimin e një aksioni të gjerë e të vazhdueshëm, që do t’u sigurojë individëve, sipas nevojës, njohuritë e nevojshme ligjore për t’u përballur me problemet ligjore që mund t’u lindin gjatë jetës së tyre, t’i aftësojë për të kuptuar legjislacionin dhe të shmangin shkeljen e ligjit. Strategjia do të shërbejë për t’i ndihmuar individët, që bazuar në njohuritë mbi legjislacionin në fuqi, të adresojnë vetë, mundësisht, problemet dhe shqetësimet që kanë. Në rastet kur vendosin të kërkojnë ndihmë dhe përfaqësim profesional nga një avokat, të jenë në gjendje të ndërtojnë së bashku me të strategjinë e ndërhyrjes ligjore dhe të jenë në gjendje të kuptojnë shërbimin që ju ofrohet nga përfaqësuesi dhe zhvillimin e procesit administrative, ose gjyqësor ku janë palë.

Nga ana tjetër, edukimi ligjor do të rritë ndërgjegjen qytetare të individëve, t’i nxitë të jenë aktivë në jetën e vendit, të respektojnë legjislacionin në fuqi dhe ta kërkojnë këtë nga administrata publike dhe individët e tjerë, duke mbajtur qëndrim kritik ndaj kujdo që i shkel ligjet, apo abuzon me to. Të rritë ndërgjegjen qytetare, duke kontribuar për mbrojtjen e zhvillimin e vlerave të shoqërisë demokratike dhe për zhvillimin pozitiv të vendit, për të ndjekur e monitoruar veprimtarinë e organeve të pushtetit shtetëror, por dhe të bashkëpunojë me to në të mirë të vendit e të interes publik. Informimi e edukimi ligjor i publikut, gjithashtu, do të duhet t’i bëjë të aftë individët që të identifikojnë nevojën për përmirësime ligjore dhe për të marrë pjesë aktive në diskutimin e

<sup>80</sup> [http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2017/PDF-2017/12-2017.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2017/PDF-2017/12-2017.pdf) fq.348.

<sup>81</sup> VKM Nr 348 datë 11.05.2015 Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim 2015-2020 (Fletore Zyrtare Nr 86, Viti 2016, fq. 4795)

projektligjeve, programeve të zhvillimit të vendit ose të sektorëve të ndryshëm, që paraqiten për shqyrtim nga administrata publike ose strukturat publike kompetente.

Vizioni do të materializohet nëpërmjet **4 Qëllimeve Strategjike** për vitet 2018-2023, të cilat kanë në themel ELP në funksion të nevojave specifike të tyre.

**Qëllimi Strategjik nr.1: Sigurimi i ELP përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, institucional dhe financiar deri më 2023.**

**Qëllimi Strategjik nr.2: Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel lokal, rajonal e kombëtar për realizimin e ELP.**

**Qëllimi Strategjik nr.3: Sigurimi i performancës efektive dhe efçente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile përmes rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve në ofrimin e ELP.**

**Qëllimi Strategjik nr.4: Ndërgjegjësim i publikut për rëndësinë e njohjes se ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.**

## **KAPITULLI IV. OBJEKTIVAT DHE PRODUKTET MADHORE**

Në këtë kapitull do të trajtohen objektivat kryesore që do të ndërmerren për zbërthimin e qëllimeve strategjike bazuar në vizionin e përcaktuar për SELP 2018-2023. Përcaktimi i objektivave nuk bazohet vetëm në renditjen e thjeshtë të tyre, por edhe në harmonizimin e tyre për arritjen e qëllimeve strategjike të përcaktuara. Konkretizimi i tyre do të bëhet nëpërmjet aktiviteteve të parashikuar në PV.

**Qëllimi Strategjik nr.1: Sigurimi i edukimit ligjor të publikut përmes përmirësimit të kuadrit ligjor, institucional dhe financiar deri më 2023.**

Me qëllim që ELP-ja të bëhet një praktikë pune gjithëpërfshirëse dhe e vazhdueshme, parashikohet përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues, për ta parashikuar këtë veprimtari si një funksion e detyrë të institucioneve e organeve të pushtetit qendror e lokal. Për këtë qëllim do të kryhet nje studim i legjislacionit ekzistues, për të parë e vlerësuar vendin dhe hapësirën, që i është dhënë ELP-së dhe evidentimin e përmirësimeve të nevojshme që i duhen bërë legjislacionit dhe kuadrit institucional.

ELP është një veprimtari që ka kosto ndaj në përputhje me PV të SELP institucionet përkatëse për realizimin e aktiviteteve të ELP-së duhet të mbajnë në konsideratë të buxheteve të tyre kostot përkatëse për realizimin e tij. Njëkohësisht, do të punohet në drejtim të thithjes së fondeve nga donatorë të ndryshëm të cilët në vazhdimësi kanë dhënë kontribut dhe mbështetje për OSHC-të në drejtim të ELP.

**Objektivi specifik 1:** Përmirësimi 100% i legjislacionit dhe kuadrit institucional të identifikuar si në nevojë për përmirësim, deri më 2023.

**01.1:** *Identifikimi i nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor dhe institucional.*

**Produkt 1.1.1:** Raporti paraprak mbi situatën e legjislacionit dhe kuadrit institucional të ELP-së i hartuar.

**01.2:** *Sigurimi i një procesi konsultimi gjithëpërfshirës;*

**Produkt 1.2.1:** Raporti paraprak i plotësuar me reflektimet e sugjerimeve të takimeve konsultuese;

**Produkt 1.2.2:** Raporti përfundimtar mbi situatën e legjislacionit dhe kuadrit institucional të ELP-së i hartuar;

**01.3:** *Përmirësimi i kuadrit ligjor e institucional nëpërmjet projekt-akteve të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi.*

**Produkt 1.3.1:** Projekt-akte të hartuara, në përputhje me rekomandimet e raportit përfundimtar;

**Produkt 1.3.2:** Legjislacioni i ndryshuar/përmirësuar është përditësuar dhe publikuar nga institucionet përgjegjëse.

**Objektivi specifik 2:** Rritja e burimeve financiare dhe njerëzore për ELP.

**02.1:** *Nxitja e strukturave përgjegjëse dhe donatorëve për mbështetjen me fondet buxhetore të nevojshme;*

**Produkt 2.1.1:** Aktivitetet ndërgjegjësuëse dhe advokuese për rritjen e nivelit të financimit të aktiviteteve të parashikuara në PV të SELP nga donatorët, të realizuara.

**Produkt 2.1.2:** Zbatimi i PV i SELP i përfshirë në planifikimin e prioriteteve të Këshillit të Ministrave dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) lidhur me shpërndarjen e fondeve publike;

**Produkt 2.1.3:** Planifikimi buxhetor i institucioneve në kuadër të ELP, i monitoruar nga Rrjeti në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse

**02.2:** *Sigurimi i burimeve njerëzore të nevojshme për të mundësuar ndërhyrjen me efektivitet;*

**Produkt 2.2.1:** Rekomandimet të hartuara dhe të përcjella tek institucionet përgjegjëse me qëllim planifikimin financiar dhe/ose marrjen e masave të nevojshme;

**Produkt 2.2.2:** Institucionet përgjegjëse për ofrimin e ELP-se të ndërgjegjësuara për nevojën e sigurimit të kapaciteteve njerëzore;

**Produkt 2.2.3:** Rekomandimet të monitoruara nga Rrjeti në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për ofrimin e ELP.

## **Qëllimi Strategjik nr.2: Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel lokal, rajonal e kombëtar për realizimin e Edukimit Ligjor të Publikut.**

Zbatimi në praktikë i SELP mund të arrihet vetëm përmes bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Ky bashkëpunim dhe bashkërendim i punës së institucioneve do të bëjë të mundur arritjen e edukimit ligjor të qytetarëve pavarësisht statusit apo profilit të tyre, nxitjen e procedimeve ligjore të sigurta, pjesëmarrjen e qytetarëve në institucione, respektimin e ligjit, aksesin në drejtësi dhe kulturën e shtetit të së drejtës. Në fjalë të fundit të gjitha këto hallka do të derivojnë në konsolidim të shtetit të së drejtës në Shqipëri.

**Objektivi specifik 1: Krijimi i strukturës ndërinstitucionale përgjegjëse për edukimin ligjor të publikut dhe zhvillimi e përmirësimi i vazhdueshëm i mekanizmave të bashkëpunimit dhe komunikimit me publikun e median.**

**O1.1 Krijimi i strukturës ndërinstitucionale përgjegjëse për edukimin ligjor të publikut dhe përcaktimi i kuadrit të veprimtarisë së saj;**

**Produkt 1.1.1:** Rrjeti Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut (Rrjeti) i ngritur nga Kuvendi;

**Produkt 1.1.2:** Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Rrjetit e hartuar nga Kuvendi;

**Produkt 1.1.3:** Faqja web e Rrjetit e krijuar.

**O1.2 Krijimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mekanizmave të bashkëpunimit të Rrjetit me publikun dhe median;**

**Produkt 1.2.1:** Kapacitetet njerëzore të nevojshme për komunikimin e vazhdueshëm të Rrjetit me median dhe publikun të siguruara dhe efektive;

**Produkt 1.2.2:** Plani i Komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median (Plani i Komunikimit) i hartuar;

**Produkt 1.2.3:** Vendime të Komisionit Drejtues, rekomandime/udhëzime të Bordit Këshillimor dhe raporte monitorimi të miratuara dhe publikuara;

**Objektivi specifik 2: Realizimi në masën 100 % i iniciativave të përbashkëta të ELP të planifikuara si rrjedhojë e institucionalizimit të bashkëpunimit në nivel lokal, rajonal dhe**

**kombëtar dhe fuqizimit të bashkëpunimit midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas.**

***Q2.1: Konkretizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional nëpërmjet realizimit të iniciativave të përbashkëta të ELP.***

**Produkt 2.2.1:** Iniciativat e përbashkëta ndërinstitucionale të ELP të zhvilluara dhe përditësuara;

***Q2.2: Rritja dhe fuqizimi i bashkëpunimit midis OSHC-ve/ klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas.***

**Produkt 2.2.1:** Databaza me OSHC-të dhe klinikat që ofrojnë ELP dhe ndihmë juridike për grupe të ndryshme të qytetarëve e ngritur.

**Produkt 2.2.2:** Memorandumi i Bashkëpunimit midis OSHC-ve, klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas i hartuar dhe nënshkruar.

**Produkt 2.2.3:** Iniciativat e përbashkëta midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas të zhvilluara.

**Qëllimi Strategjik nr.3: Sigurimi i performancës efektive dhe efçente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile përmes rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve në ofrimin e edukimit ligjor të publikut.**

Të nxënit efektiv në fushën e edukimit ligjor përfshin një gamë të gjerë aktorësh. Ky qëllim strategjik synon të sigurojë mbështetje dhe përmirësim të kapaciteteve të institucioneve publike, të pavarura, medias dhe shoqërisë civile në ofrimin e edukimit ligjor të publikut. Trajnimi i vazhdueshëm i target grupeve që do të ofrojnë edukim ligjor është domosdoshmëri për përcjelljen e një informacioni efektiv, të qëndrueshëm dhe të planifikuar në këtë fushë. Ofruesit e edukimit ligjor duhet të ndjekin trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm me qëllim, që të zotërojnë njohuri dhe parime të mjaftueshme në fushën ligjore, por edhe aftësi pedagogjike për përcjelljen e informacionit tek qytetarët.

Qasja ndaj edukimit dhe metodat trajnuese duhet të hartohen në mënyrë të tillë, që të përcjellin mesazhin e bashkëjetesës në një shoqëri demokratike, që udhëhiqet nga garantimi, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut. Për më tepër hartimi i programeve të dedikuara për secilin grup cinformacionit nga publiku, por edhe shmang mbivendosjet tematike për aq sa është e mundur.

**Objektivi specifik 1: Përmirësimi i kuadrit metodologjik në lidhje me ofrimin e ELP nga institucionet publike, të pavarura, medias dhe shoqëria civile në masën 50% deri në 2023:**

***Q1.1: Hartimi i një kuadri metodologjik në përputhje me nevojat e target grupit ofrues të ELP;***

**Produkt 1.1.1:** Vlerësimi mbi nevojat për hartim apo përmirësime në programet e trajnimit dhe kurrikulat i hartuar;

**Produkt 1.1.2:** Modulet e trajnimit dhe kurrikulat sipas nevojave përkatëse të hartuara.

**Produkt 1.1.3:** Modulet e trajnimit të miratuara.

***01.2: Zhvillimi i një kuadri metodologjik që orienton në vazhdimësi përmbajtjen e programeve për ELP të çdo institucioni;***

**Produkt 1.2.1:** Udhëzuesi për përmbajtjen e programeve të ELP të çdo institucioni, i hartuar dhe miratuar.

**Objektivi specifik 2: Inkurajimi për rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile në lidhje me ofrimin e edukimit ligjor të publikut në masën 50%, deri në 2023.**

***02.1: Përmirësimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të institucioneve publike në lidhje me ofrimin e edukimit ligjor të publikut;***

**Produkt 2.1.1:** Punonjës të institucioneve publike të trajnuar;

**Produkt 2.1.2:** Modulet e trajnimit për ofrimin e ELP të përmirësuara në vazhdimësi;

**Produkt 2.1.3:** Programet për ELP-së nga secili institucion publik të përditësuara dhe përmirësuara.

***02.2: Inkurajimi për rritjen e kapaciteteve të institucioneve të pavarura, medias dhe shoqërisë civile në lidhje me ofrimin e edukimit ligjor të publikut;***

**Produkt 2.2.1:** Punonjësit e institucioneve të pavarura, medias dhe shoqërisë civile, të trajnuar në përputhje me modulet e miratuara;

**Produkt 2.2.2:** Modulet e trajnimit për ofrimin e ELP të përmirësuara;

**Produkt 2.2.3:** Programet për ofrimin e ELP-së nga institucionet e pavarura, media dhe shoqëria civile të përditësuara dhe përmirësuara.

**Qëllimi Strategjik nr.4: Ndërgjegjësim i publikut për rëndësinë e njohjes se ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.**

Edukimi ligjor është një komponent kyç për një qasje holistike ndaj shërbimeve ligjore. Ofrimi i shërbimeve juridike do të thotë më shumë sesa thjesht të jepen këshilla apo perfaqësim në dispozicion të personave pasi ata tashmë kanë përjetuar një problem ligjor.

Përmirësimi i njohjes së ligjit dhe të drejtave mund t'i pajisë individët me aftësi për të menaxhuar më mirë problemet e tyre. Ekziston një nevojë e qartë për të siguruar informacion dhe mbështetje të



përshtatshme për ata njerëz që janë të prirur për t'u vetëpërfaqësuar, veçanërisht kur ndihma ligjore mungon apo është e vështirë për t'u marrë. Kjo mbështetje mund t'u japë atyre besimin për të vlerësuar se kur duhet ta zgjidhin vetë një problem dhe në të njëjtën kohë për të kuptuar se kur duhet kërkuar një këshillë profesionale. Aftësimi i personave që kanë mundësi të vetëpërfaqësohen, me pak këshillim, mund të jetë një mënyrë me kosto shumë efektive kur bëhet fjalë për çështje me vlerë të vogël apo jo të rëndësishme.

Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes se ligjit dhe edukimi i vazhdueshëm ligjor i tyre, do të ketë këto funksione:

- ✓ Sigurimin e njohurive ligjore parandaluese ose mbrojtëse, duke përfshirë njohuri mbi një 'rast apo çështje të caktuar' si dhe njohuri të përgjithshme mbi ligjin.
- ✓ Pajisjen me materiale edukuese ligjore për një person apo grup të caktuar personash, ndërsa po përjetojnë një problem ligjor.
- ✓ Ofrimin e mbështetjes në rastet kur personi/apo personat janë të gatshëm të vetëpërfaqësohen lidhur me problemin e tyre ligjor.
- ✓ Ofrimin e udhëzimeve dhe koordinatave për individët që dëshirojnë të gjejnë një shërbim ligjor të përshtatshëm.
- ✓ Ofrimin e informacionit rreth zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve.
- ✓ Ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes që individët të jenë faktor efektiv për ndryshim atëherë kur ligjet nuk janë të përshtatshëm në shoqëri.
- ✓ Ofrimin e ndihmës për qytetarët që ata të jenë me vetëbesim, të informuar dhe qytetarë aktivë.
- ✓ Mbështetjen e një kulture të të drejtave të njeriut, bazuar në një kuptim të përbashkët të vlerave të të drejtave të njeriut.

### **Objektiv specifik 1: Rritja e aksesit të publikut në informacion**

***01.1: Krijimi dhe publikimi i materialeve që fokusohen në tema të veçanta ligjore dhe/ose me interes për grupe të qytetarëve me nevoja të veçanta, në formate të përshtatshme lehtësisht të aksesueshme;***



**Produkt 1.1.1:** Materialet e hartuara dhe të shpërndara tek qytetarët, institucionet dhe në faqe të ndryshme online.

**Produkt 1.1.2:** Faqet/portalet/forumet e tjera ekzistuese të integruara në faqen e Rrjeti.

**01.2 Bashkëpunimi i vazhdueshëm me median;**

**Produkt 1.2.1:** Realizimi i programacioneve mediatike në bazë të parashikimeve të Planit të Komunikimit të Rrjetit me publikun dhe median.

**Produkt 1.2.2:** Rubrikat/seksionet e veçanta për çështje ligjore në gazeta dhe revista me tirazh të lartë të hartuara.

**Produkt 1.2.3:** Qytetarë të informuar nëpërmjet medias

**Objektivi specifik 2: Rritja e kapaciteteve të individëve në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe garantimi i informacionit ligjor në kohë reale dhe sa më pranë komunitetit.**

**02.1: Zhvillimi i paketave ndihmëse për vetëpërfaqësimin e qytetarëve duke përfshirë forma/modele të gatshme të standartizuara;**

**Produkt 2.1.1:** Raporti për analizimin e nevojave të qytetarëve i hartuar.

**Produkt 2.1.2:** Modelet e gatshme për vetëpërfaqësim në institucione të hartuara dhe publikuara.

**02.2: Krijimi i kanaleve të komunikimit dhe informimit ligjor në kohë reale të qytetarëve;**

**Produkt 2.2.1:** Linjat telefonike "help line" që ofrojnë informacione rreth aspekteve të ligjit të krijuara në çdo bashki.

**Produkt 2.2.2:** Qytetarët të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore, nëpërmjet aktiviteteteve me studentë të ligjit dhe avokatë të specializuar;

**Produkt 2.2.3:** Ditët e hapura pranë Bashkive për t'u njohur me punën e institucioneve, fushën e veprimtarisë dhe me shërbimet që ofrohen në nivel lokal të zhvilluara.

**Objektivi specifik 3: Përfshirja e edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar.**

**0.3.1 Plotësimi i kurrikulave mësimore parauniversitare me kapituj e seksione të veçanta që fuqizojnë nxënësit me dije dhe kulturë ligjore;**

**Produkt 3.1.1:** Kurrikulat mësimore që do të ndryshohen/plotësohen të identifikuara dhe të ndryshuara.

**0.3.2 Edukimi i fëmijëve me kulturën ligjore në shkolla dhe fuqizimi i tyre përmes informimit mbi të drejtat dhe mbi strukturat mbrojtëse të tyre;**

**Produkt 3.2.1:** Modulet e trajnimit të mësuesve të hartuara;

**Produkt 3.2.2:** Mësues të trajnuar;

**Produkt 3.2.3:** Modulet e trajnimit të përditësuara.

**Produkt 3.2.3:** Modulet e trajnimit të përditësuara.

## KAPITULLI V. BURIMET FINANCIARE

Siç është shpjeguar edhe më sipër, SELP synon të përcaktojë qëllimet strategjike, objektivat dhe produktet madhore të ELP për vitet 2018-2023. Kjo Strategji shoqërohet nga Planit i Veprimit i cili detajon aktivitetet në fushën e ELP për vitet 2018-2020. Duke marrë në konsideratë përgjegjësitë e *Ministrisë së Drejtësisë* të sanksionuara në ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, PV për zbatimin e SELP do të hartohet nën mbikqyrjen dhe koordinimin e kësaj Ministrie dhe do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Parashikohet që Planit i Veprimit të hartohet brenda 6 mujorit të parë të vitit 2018.

Rrjedhimisht, shpërndarja në vija të përgjithshme e burimeve financiare që financojnë aktivitetet e Planit të Veprimit 2018-2020 në zbatim të SELP mund të parashikohet me rishikimin e buxhetit të vitit 2018 dhe në buxhetin e vitit 2019 dhe 2020. Kostot e zbatimit të masave konkrete të PV do të paraqiten nga secili institucion përgjegjës për zbatimin e tyre.

Financimi i Planit të Veprimit të SELP do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e komunitetit të donatorëve.

## KAPITULLI VI. LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Siç është shpjeguar në Kapitullin II të këtij dokumenti, SELP përputhet plotësisht me dokumentat strategjikë në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave duke bërë që vizioni, qëllimet strategjike dhe objektivat e parashikuar të përputhen plotësisht me këta dokumente strategjike.

### ***VI.1 Institucionet zbatuese të SELP dhe të Planit të Veprimit***

SELP përbën dokumentin bazë të edukimit ligjor të publikut që do të respektohet nga *të gjithë institucionet publike dhe private të parashikuar në këtë dokument*. Ky dokument është gjithashtu udhërrëfyese strategjik që duhet të ndjek *Kuvendi i Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave* në kuadër të ELP-së. Përmbushja e vizionit, qëllimeve strategjike dhe objektivave që ka përcaktuar ky dokument

do të realizohet nëpërmjet hartimit të PV-së, i cili do të jetë në përputhje me çfarë parashikohet në këtë Strategji.

Duke marrë në konsideratë se *Ministria e Drejtësisë* funksionon mbi bazën e Ligjit Nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, (të ndryshuar), në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe integritit evropian të Republikës së Shqipërisë. Sipas këtij ligji, ajo kujdeset dhe mbështet veprimtaritë shkencore në fushën e drejtësisë dhe përhapjen e edukatës juridike, si dhe kujdeset për ndjekjen dhe bashkërendimin e marrëdhënieve me shoqërinë civile për fushën e drejtësisë. *Rrjedhimisht, PV-ja për zbatimin e SELP do të hartohet nën mbikqyrjen dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, brenda 6 mujorit të parë të 2018, dhe do të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave duke u konsultuar me të gjithë institucionet/agjencitë e tjera zbatuese, përfshirë edhe shoqërinë civile.*

*Kuvendi i Republikës së Shqipërisë do të iniciojë menjëherë ngritjen e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut i cili, do të ketë në përbërje të tij përfaqësues të:*

1. Institucionit të Presidentit;
2. Kuvendit;
3. Kryeministrisë;
4. Avokatit të Popullit;
5. Ministrisë përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
6. Ministrisë përgjegjëse për arsimin;
7. Ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme;
8. Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale;
9. Ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme;
10. Ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën;
11. Ministrisë përgjegjëse për fushën e tregtisë;
12. Ministrisë përgjegjëse për turizmin;
13. Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
14. Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
15. Strukturës e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
16. Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas ;
17. Autoritetit të Mediave Audiovizive;
18. Radio Televizioni Shqiptar;
19. Këshillit të Lartë Gjyqësor;
20. Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
21. Shkollës së Magjistraturës;

22. Dhomës Kombëtare e Noterisë;
23. Dhomës Kombëtare e Avokatisë;
24. Dhomës Kombëtare e Ndërmjetësve;
25. Dhomës Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë;
26. Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
27. Bashkive;
28. Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile;
29. 5 (pesë) Organizatave të Shoqërisë Civile që punojnë për edukimin ligjor të publikut;
30. Organizata Ndërkombëtare;
31. 2 (dy) fakulteteve të drejtësisë që kanë klinika ligjore (një publik dhe një privat).

Ngritja e Rrjetit dhe funksionimi i tij do të mbikqyret dhe drejtohet nga Kuvendi përfaqësuesi i të cilit, do të mbajë edhe funksionin e kryetarit të *Komisionit Drejtues*. Ky Rrjet do të organizohet në organe të thjeshta koordinuese e zbatuese dhe secili prej tyre do të ketë një funksion të mirëpërcaktuar në kuadër të zbatimit dhe përmirësimit të SELP dhe PV.

Rrjeti do të ndërtohet nëpërmjet caktimit, nga secili institucion i sipërpërmendur, i përfaqësuesit të tij.

Organet e Rrjetit do të jenë *Komisioni Drejtues dhe Bordi Këshillimor*.

*Komisioni Drejtues* është organi vendimarrës i Rrjetit i cili, do të përbëhet nga të paktën përfaqësuesit e institucioneve të mëposhtme:

1. Kuvendit;
2. Kryeministrisë;
3. Ministrisë përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
4. Ministrisë përgjegjëse për arsimin;
5. Ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme;
6. Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
7. Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
8. Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas;
9. Autoritetit të Mediave Audiovizive;
10. Këshillit të Lartë Gjyqësor;
11. 2 (dy) Organizatave të Shoqërisë Civile që punojnë për edukimin ligjor të publikut;
12. 1 (një) fakultet drejtësie që ka klinikë ligjore.

Përfaqësuesit e institucioneve do të shërbejnë edhe si pika kontakti për institucionet e tyre, ndaj ata duhet të kenë akses në nivelet më të larta vendimmarrëse brenda institucioneve të tyre për të siguruar

zbatimin e SELP dhe PV në secilin institucion. Kryetari i Komisionit Drejtues organizon takime të Komisionit sipas nevojës.

*Bordi Këshillimor*, i cili përbëhet nga zyrtarë të lartë të institucioneve të Rrjetit ka një rol udhëzues dhe këshillimor të Komisionit Drejtues në plotësimin dhe përmirësimin e politikave në fushën e edukimit ligjor të publikut.

Rrjeti do të mbështetet nga një *Sekretariat teknik* i cili, do të ngrihet nga Kuvendi që do të sigurojë edhe kapacitetet njerëzore dhe financiare të nevojshme për funksionimin e tij .

Në këtë kontekst, zbatimi i Strategjisë do të realizohet përmes koordinimit dhe mbikqyrjes së punës nga Komisioni Drejtues i Rrjetit. Mbikqyrja dhe koordinimi i punës midis institucioneve të Rrjetit do të konsistojë në koordinimin e punës për zbatimin e strategjisë, përmirësimin të mëtejshëm të PV të SELP hartuar nga Ministria e Drejtësisë dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave, monitorimit të zbatimit të PV dhe raportimit publik mbi progresin e zbatimit të tij.

## ***VI.2 Institucionet monitoruese të zbatimit të SELP dhe PV***

*Komisioni Drejtues* i Rrjetit do të monitorojë zbatimin e SELP dhe PV nga të gjithë institucionet e përfshira në këtë dokument. Komisioni Drejtues i Rrjetit do të monitorojë:

1. Hartimin e PV nga Ministria e Drejtësisë e cila do të raportojë çdo 3 muaj mbi ecurinë e procesit të hartimit, koordinimit të institucioneve dhe parashikimet PV të SELP deri në miratimin e tij me Vendim të Këshillit të Ministrave;
2. Përputhshmërinë e PV me vizionin, qëllimet strategjike dhe objektivat e parashikuar në këtë Strategji;
3. Zbatimin e PV nga institucionet përgjegjëse nëpërmjet raportimit çdo 6 muaj nga Ministria e Drejtësisë dhe nga secili institucion anëtar i Rrjetit dhe përgjegjës për zbatimin e SELP;
4. Përmirësimin e vazhdueshëm të zbatimit të SELP dhe PV nëpërmjet konsultimit çdo 6 muaj me Bordin Këshillimor të Rrjetit;
5. Plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të politikave të parashikuara në Strategji dhe PV nëpërmjet konsultimit çdo 6 muaj me Bordin Këshillimor të Rrjetit.

*Ministria e Drejtësisë* do të monitorojë zbatimin e SELP dhe PV me synim arritjen e qëllimeve dhe objektiveve të SELP me mbështetjen dhe kontributin e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij. Monitorimi i zbatimit të SELP dhe PV nga Ministria e Drejtësisë do të realizohet nëpërmjet aktiviteteve si më poshtë:

1. Mbledhja e projekt-raporteve të monitorimit të institucioneve;
2. Shqyrtimit të projekt-raporteve të veprimit të dorëzuara nga institucionet;
3. Hartimit të raportit të monitorimit 6 mujor dhe vjetor të zbatimit të SELP dhe PV;

4. Dërgimit të raportit 6 mujor të monitorimit për diskutim në Komisionin Drejtues të Rrjetit;
5. Dërgimit të progress raportit vjetor të monitorimit të zbatimit të SELP dhe PV për diskutim dhe miratim në Komisionin Drejtues të Rrjetit;
6. Përcjelljen e vendimeve të Komisionit Drejtues të Rrjetit së bashku me udhëzimet e Bordit Këshillimor tek institucionet;
7. Raportimi vjetor në Kuvend për zbatimin e SELP dhe PV;
8. Publikimin e raporteve vjetore të miratuara;
9. Përditësimin dhe përmirësimin e PV sipas udhëzimeve të Bordit Këshillimor dhe vendimit të Komisionit Drejtues të Rrjetit.

### ***VI.3 Raportimi periodik, metodologjia e raportimit dhe raportimet publike***

Me miratimin e PV nga Këshilli i Ministrave, secili institucion përgjegjës për zbatimin e Strategjisë dhe PV do të raportojë pranë Ministrisë së Drejtësisë, çdo 3 muaj, mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë dhe PV.

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin 6 mujor të monitorimit dhe do ta dërgoj atë për diskutim në Komisionin Drejtues të Rrjetit.

Komisioni drejtues do të organizojë çdo 6 muaj një takim për një analizë më të thelluar të problematikave të hasura.

Në muajin dhjetor të çdo viti, Ministria e Drejtësisë i paraqet Komisionit Drejtues për diskutim dhe miratim raport progresin vjetor të zbatimit të SELP dhe PV. Pasi të jetë miratuar nga Komisioni Drejtues i Rrjetit, ky raport progres vjetor i përcillet për dijeni Kryetarit, nën kryetarit dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si dhe bëhet publik.

Gjithashtu, një takim do të organizohet çdo fillim viti me të gjithë anëtarët e Rrjetit me qëllim diskutimin mbi problematikat, politikat dhe masat e ardhshme në kuadër të edukimit ligjor të publikut.

PV do të jetë një dokument që do të ndryshojë dhe do të përditësohet çdo vit sipas rekomandimeve të Bordit Këshillimor dhe vendimmarrjes së Komisionit Drejtues i cili, do t'ia përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për të vijuar me procedurat e miratimit.

Mjetet dhe mënyrat me të cilat do të raportohet, si p.sh. raporte shkresore, formularë, sisteme/programe elektronike komunikimi të informacionit etj., do të miratohen nga Komisioni Drejtues i Rrjetit.

Këshilli i Ministrave i raporton në mënyrë periodike Komisionit Drejtues të Rrjetit në lidhje me burimet financiare që do të angazhohen për përmbushjen e PV.

Bordi Këshillimor mund të rekomandojë në mënyrë të vazhdueshme metoda dhe mekanizma të monitorimit nga Komisioni Drejtues i Rrjetit dhe Ministria e Drejtësisë.

#### **VI.4 Analiza vlerësuese**

SELP do t'i nënshtrohet një procesi vlerësimi afatmesëm, i cili parashikohet të kryhet në fund të vitit 2020. Vlerësimi do të përfshijë periudhën 2018-2020 dhe do të evidentojë arritjet e dy viteve të para të zbatimit të SELP në lidhje me rezultatet e parashikuara dhe nivelin e arritjes së objektivave të strategjisë. Vlerësimi afatmesëm do të shërbejë për përcaktimin e një plani më të saktë të aktiviteteve për periudhën 2020-2023, për një vlerësim të nevojave financiare për zbatimin e strategjisë për tre-vecarin e ardhshëm duke orientuar kështu programimin e burimeve në kuadër të PBA-së.

Gjithashtu, në përfundim të afatit të strategjisë, do të hartohet një raport vlerësimi lidhur me zbatimin e strategjisë dhe impaktin e saj.

Bordi Këshillimor do të rekomandojë metodologjinë që do të përcaktojë se si do të realizohet procesi i vlerësimit të SELP në mënyrë të vazhdueshme.

#### **VI.5 Treguesit e Monitorimit të SELP**

Zbatimi i SELP do të bazohet në përdorimin e një numri treguesish që do të mundësojnë vlerësimin e zbatimit të SELP dhe të PV. Treguesit janë të përcaktuar sipas qëllimeve strategjike të parashikuara në SELP të cilët mundësojnë vlerësimin periodik të zbatimit të saj. Tabela e mëposhtme eidenton treguesit sipas qëllimeve strategjike të SELP.

<b>Përshkrimi i treguesit</b>	<b>Vlera Bazë/ 2018</b>	<b>Synimi për 2020</b>	<b>Synimi për 2023</b>	<b>Burimet e verifikimit</b>
<b><i>Qëllimi Strategjik nr.1: Sigurimi i edukimit ligjor të publikut përmes plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor, institucional dhe financiar deri më 2023.</i></b>				
OS.1 Përmirësimi 100% i legjislacionit dhe kuadrit institucional të identifikuar si në	0	<30 % e projekt-akteve të identifikuar	100 % e projekt-akteve të identifikuar	Raporte periodike dhe raportet e vlerësimit ; Akte ligjore dhe nënligjore të miratuara

nevojë për përmirësim, deri më 2023.				
OS.2 Rritja e burimeve financiare dhe njerëzore për ELP.	0	100 % e PV 2018-2020	100 % e PV sipas viteve	Buxheti i shtetit, i bashkive dhe donatorëve;
<b><i>Qëllimi Strategjik nr.2: Garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitucional në nivel lokal, rajonal e kombëtar për realizimin e Edukimit Ligjor të Publikut.</i></b>				
OS.1 Krijimi i strukturës ndërinstitucionale përgjegjëse për edukimin ligjor të publikut dhe zhvillimi e përmirësimi i vazhdueshëm i mekanizmave të bashkëpunimit dhe komunikimit me publikun e median.	0	I ngritur dhe funksional	Përmirësuar funksionimi dhe zgjeruar anëtarësia	Raporte të Komisionit Drejtues të Rrjetit;
OS.2 Realizimi në masën 100 % i iniciativave të përbashkëta të ELP të planifikuara si rrjedhojë e institucionalizimit të bashkëpunimit në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar dhe fuqizimit të bashkëpunimit midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas.	0	100 % e iniciativave të përbashkëta të PV 2018-2020;  Bashkëpunimi midis OSHC-ve/klinikave të ligjit dhe organit që administron ndihmën juridike falas është formalizuar.	100 % e iniciativave të përbashkëta të PV sipas viteve	Raporte periodike dhe raportet e vlerësimit;  Marrëveshje bashkëpunimi;



**Qëllimi Strategjik nr.3: Sigurimi i performancës efektive dhe efiente të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile përmes rritjes së vazhdueshme të kapaciteteve në ofrimin e edukimit ligjor të publikut.**

OS.1 Përmirësimi i kuadrit metodologjik në lidhje me ofrimin e ELP nga institucionet publike, të pavarura, medias dhe shoqëria civile në masën 50% deri në 2023.	0	<50 %	Përmirësim i moduleve	Modulet e trajnimit;
OS.2 Inkurajimi për rritjen e kapaciteteve të institucioneve publike dhe të pavarura, medias dhe shoqërisë civile në lidhje me ofrimin e edukimit ligjor të publikut në masën 50%, deri në 2023	0	<20 %	50 % vazhdues	Raporte periodike dhe raportet e vlerësimit;

**Qëllimi Strategjik nr.4: Ndërgjegjësim i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.**

OS.1 Rritja e aksesit të publikut në informacion	>30%	<30 %	<50%	Anketim në nivel kombëtar;
OS.2 Rritja e kapaciteteve të individëve në ushtrimin e të drejtave të tyre dhe garantimi i informacionit ligjor në kohë reale dhe sa më pranë komunitetit.	30%	<30 %	<50%	Raporte periodike dhe raportet e vlerësimit; Anketim në nivel kombëtar; Linja telefonike "help line"; Programet elektronike dhe portali i dedikuar;

OS.3 Përfshirja e edukimit ligjor në lëndët bazë të arsimit parauniversitar.	0	<30 %	70%	Raporte periodike dhe raportet e vlerësimit  Kurrikulat e plotësuara/përmirësuara
--	---	-------	-----	---

DRAFT